Qëllimi i çdo legjislatori, në ligjet që miraton, është ofrimi për një kohë të gjatë i garancisë juridike. Në fazat e konsultimit dhe diskutimit përpiqet të përfshijë në të situata të së tashmës, madje dhe duke “parashikuar” ato të së ardhmes në mënyrë që legjislacioni të jetë sa më i plotë e gjithëpërfshirës. Por, edhe legjislatori më i mirë në botë e ka të pamundur ta realizojë atë efektivisht, në këtë shoqëri e cila evoluon me hapa galopant.

Duke folur konkretisht Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 Kodi i Procedurës

Civile i Republikës së Shqipërisë ka pësuar disa ndryshime të cilat kanë ardhur nëpërmjet: Ligjit nr. 8431, datë 14.12.1998; Ligjit nr. 8491, datë 27.5.1999; Ligjit nr. 8535, datë 18.10.1999; Ligjit nr. 8812, datë 17.5.2001; Ligjit nr. 9062, datë 8.5.2003; Ligjit nr. 9953, datë 14.7.2008; Ligjit nr. 10 052, datë 29.12.2008; Ligjit nr. 49/2012, datë 19.4.2012; Ligjit 122/2013, datë 18.4.2013; Ligjit 160/2013, datë 17.10.2013; Ligjit nr. 114/2016, datë 3.11.2016; Ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017; Ligjit nr. 44/2021, datë 23.3.2021.

Konstatohet se ka vitit 1996 (viti i hyrjes së fuqi të tij) e deri në vitin 2021 legjislatori ka ndërhyrë 13 herë në funksion të përmirësimit të procedurave gjyqësore civile. Ndryshimet e fundit me Ligjit Nr.44/2021 mund të konsiderohet që kanë pasur synim:

Rritjen e efektivitetit të gjykatave gjatë shqyrtimit të çështjeve;

Ndryshime të përbërjes së trupave gjyqësore;

Rikategorizim i “padive të vogla”;

Ndryshim në disa momente i procedurës së gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Duke u ndalur kryesisht në ndërhyrjet që janë bërë në gjykimet në Gjykatën e Lartë mund të themi se risia e këtij ligji ishte shtesa e nenit 483 pika/a me titullimin “Procedimet paragjykimore”.

Ky parashikim ligjor i atribuoi Kolegji Civil ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për herë të pare, se gjatë shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, mund të vendosin t’i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare. Kjo mund të realizohet sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, dhe në këtë rast marrin vendim për pezullimin e shqyrtimit të çështjes. Ky vendim pezullimi zgjat deri në dhënien e vendimit nga gjykata ndërkombëtare. Palëve u njoftohet ky vendimi i gjykatës ndërkombëtare së bashku me datën e seancës së radhës në Gjykatën e Lartë.

Përveç sa më sipër risi e këtij ligji ka qënë dhe ndërhyrja e legjislatorit në lidhje me njehsimin e praktikës gjyqësore. Ky ligj parashikoi se për shkak të interesit që paraqet njehsimi ose ndryshimi i praktikeës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendim me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë që çmohet se kanë njohuri të posaçme eër çështjet ligjore të shtruara për njehsim ose ndryshim të praktikës gjyqësore.

Në “dyert” e legjilatorit tonë, është një projektligj/2024 në të cilin synohen të bëhen ndryshime të mëtejshme ligjore në Kodin e Procedurave Civile. Këto ndryshime synojnë të prekin nenin 35, nenin 510, 511 dhe 514 të këtij kodi.

Ky projekt ligj në pjesën e parë të tij synon të bëjë ndërhyrje që kanë lidhje me llojin e çështjeve që do të gjykohen nga Gjykatën e Apelit me një gjyqtar duke i vendosur nominalisht ato, konkretisht:

“Gjykata e Apelit shqyrtoin me një gjyqtar të vetëm këto çështje:

Ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktore.

Akimimet e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare dhe atyre të ndërmjetme, me përjashtim të ankimit të veçantë kundër vendimit të ndërmjetëm të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 370 të këtij kodi;

Rastet e tjera kur në këtë Kod ankimi i veçantë parashikohet si mjet kundërshtimi për vendimin e gjykatës;

Ankimimet kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi dhe të heqjes dorë nga e drejta e padisë, si edhe kërkesat e heqjes dorë nga gjykimi ose nga ankimi apo ankimi i veçantë, të paraqitura në gjykatën e apelit.

Ankimet dhe ankimet e veçanta kundër vendimeve për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore.

Në raste të tjera të parashikuara në Kod

Duket sikur kjo dispozitë ka për qëllim reduktimin e mëtejshëm të ngarkesës në Gjykatën e Apelit, duke kaluar shqyrtimin e disa ankimeve jo me trupë gjyqësore të përbërë nga 3 gjyqtarë, por për rastet e përmendura më sipër, të mund të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

Gjithashtu rëndësia e kësaj dispozite shihet dhe në parashikimin “... Rastet e tjera kur në këtë Kod ankimi i veçantë parashikohet si mjet kundërshtimi për vendimin e gjykatës”. Në këtë moment legjislatori, për të gjitha ato rastet që nuk janë të përmendura nominalisht në këtë dispozitë, por që gjenerohen në nene të tjera, ku përmendet ankimi i veçantë si mjet procedural, i cili ka rregulla dhe parashikime të veçanta ligjore, i përfshin në këtë dispozitë, duke i bërë pjesë integrale të saj.

Ai që është thelbi i këtij punimi lidhet me ndërhyrjet e tjera që kërkohen të bëhen që janë të lidhura me titujt ekzekutivë. Konkretisht në nenin 510, synohet të përfshihen në kategorinë e titujve ekzekutiv:

Aktmarrëveshjet me të cilat bashkëshortët japin pëlqimin reciprok për zgjidhjen e martesës së tyre, nëpërmjet kundërfimimit të saj nga avokatët e tyre dhe të vërtetuara zyrtarisht nga Noteri, në përputhje me masat e parashikuara nga Kodi i Familjes;

Titujt ekzekutiv të lëshuara nga nëpunësit publikë ose personat juridikë të së drejtës publike të cilësuar si të tilla me ligj, ose vendimet e të cilave ligji u jep efektet e një vendimi.

Në lidhje me pikën 1 shihet një ndryshim thelbësor sa i përket të drejtës

familjare. Ndryshimet e fundit ligjore sa i përket zgjidhjes së martesës, jep mundësinë që palët që vendosin ta zgjidhin atë me marrëveshje ndërmjet tyre, kjo e fundit mund të nënshkruhet:

Përpara noterit publik, dhe më pas të paraqitet kërkesë në Gjykatën kompetente, dhe ajo të vendosë në fund mbi miratimin ose jo të saj;

Me anë të ndërmjetësimit, dhe në këtë rast marrëveshja paraqitet përpara Gjykatës kompetente e cila me vendim vendosë mbi miratimin ose jo të saj.

Në lidhje me ndryshimet e fundit ligjore që lidhen me zgjidhjen e martesës nëpërmjet marrëveshjes ndërmjet palëve, është e qartë se legjislatori ka synuar të ofrojë një mundësi më të shpejtë dhe më të thjeshtë për çiftet që duan të ndajnë jetën e tyre bashkëshortore, duke përdorur mekanizma alternative si nënshkrimi i marrëveshjeve përpara noterit ose ndërmjetësimit. Ky ndryshim i sjell disa aspekte që meritojnë një shqyrtim më të thelluar dhe një analizë të kujdesshme nga ana juridike.

Roli i Gjykatës si “filtri” përfundimtar për Marrëveshjet e Zgjidhjes së Martesës:

Një nga risitë më të rëndësishme të këtij ndryshimi është se, pavarësisht që palët mund të arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e martesës përmes noterit ose ndërmjetësimit, vendimi përfundimtar mbi miratimin e kësaj marrëveshjeje i takon gjithmonë gjykatës. Kjo do të thotë se, edhe pse procesi i arritjes së marrëveshjes mund të jetë jashtë sistemit gjyqësor, kontrolli dhe miratimi i saj mbeten në dorën e gjykatës. Ky parim ka për qëllim të sigurojë që çdo marrëveshje që ndodhet në kundërshtim me interesat e palëve ose që ka efekte të padrejta për njëra palë, të mund të refuzohet nga gjykata. Kjo është një masë mbrojtëse për sigurinë dhe drejtësinë, duke garantuar që të drejtat e individëve, veçanërisht ato që lidhen me fëmijët dhe pasuritë, të respektohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Megjithatë, ky mekanizëm gjithashtu sjell disa sfida të natyrës juridike dhe praktike. Kjo pasi që, megjithëse gjykata ka mundësinë të miratojë marrëveshjen, procedura e miratimit mund të jetë e ngadaltë, duke e ngarkuar më tej gjykatën me çështje që mund të ishin përfunduar jashtë saj. Nëse gjykata do të jetë e detyruar të shqyrtojë çdo marrëveshje të bërë përpara noterit ose pas ndërmjetësimit, kjo mund të krijojë vonesa të panevojshme dhe mund të ngarkojë sistemin gjyqësor me një numër të lartë çështjesh që mund të ishin më efektivisht të zgjidhura përmes proceseve jashtëgjyqësore.

2. Efektet e Ndryshimeve në Shpejtësinë dhe Efektivitetin e Zgjidhjes së Martesës:

Një nga argumentet kryesore të legjislatorit për këtë ndryshim është se

procesi i zgjidhjes së martesës mund të përshpejtohet duke ofruar mundësi alternative si ndërmjetësimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve përpara noterëve. Ky është një hap pozitiv për ata që kërkojnë një zgjidhje të shpejtë dhe pa konflikte të theksuara, pasi mund të përshpejtojë procedurat dhe të ulë kostot e procesit gjyqësor. Palët mund të arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e martesës pa nevojën për të kaluar në një proces të gjatë dhe të shtrenjtë gjyqësor. Megjithatë, duhet të vlerësohet se, ndonëse mund të sjellë një shpejtim të procesit, ky ndryshim gjithashtu mund të ketë efekte të papritura në cilësinë e procesit të drejtësisë dhe të marrëveshjeve që arrijnë palët. Kur palët kanë mundësinë të arrijnë marrëveshje përpara noterit ose ndërmjetësit, mund të ndodhin situata ku njëra palë mund të shfrytëzohet për shkak të një ndikimi të jashtëm ose për shkak të pabarazisë në njohuritë ligjore. Ky problem mund të zgjidhet vetëm nëse ligji siguron mundësi për mbrojtjen e të drejtave të palëve në çdo fazë të procesit dhe që kontrolli gjyqësor të mbetet efektiv.

3. Pasojat e Vonimeve në Rregullimin e Pasojave të Zgjidhjes së Martesës:

Përveç aspekteve procedurale, një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij ndryshimi lidhet me pasojat psikologjike dhe ligjore që mund të shkaktohen nga vonesat në zgjidhjen e martesës. Kur palët janë të detyruara të presin një periudhë të gjatë për të rregulluar pasojat e martesës (si pasuria dhe kujdesi për fëmijët), kjo mund të shkaktojë tensione të mëdha psikologjike, duke shtuar ndjeshmërinë e situatës dhe duke mundësuar që ndodhin konflikte të tjera gjatë periudhës së pritjes. Zgjidhja e shpejtë përmes ndërmjetësimit mund të ofrojë mundësi për të reduktuar këto pasoja, por vetëm nëse procesi është i sigurt dhe i mbikëqyrur nga gjykata. Kjo situatë tregon se duhet të bëhet një balancim i kujdesshëm mes shpejtësisë dhe kontrollit gjyqësor. Ndryshimi që ofron mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjeve përpara noterit dhe ndërmjetësit është një mundësi për të shpejtuar procesin, por duhet të sigurohet që ky ndryshim të mos shkojë në dëm të cilësisë së zgjidhjes dhe të drejtësisë që ofrohet për palët e përfshira.

Siç shihet, filtri i fundit që ka vendosur legjislatori mbi zgjidhjen e martesës me marrëveshje ndërmjet palëve, pavarësisht nëse ajo lidhej përpara Noterit publik apo një ndërmjetësi, është Gjykata. Mirëpo de facto, kjo procedurë, përveç se ngarkonte gjykatën më çështje, në opinionin tim ky ndryshim do të sjellë dy efekte të rëndësishme në proceset gjyqësore:

Së pari ulje të ngarkesës së Gjykatës;

Së dyti, që e vlerësoj edhe më të rëndësishme, do të përshpejtojë çështjet

e zgjidhjes së martesës, ku për mendimin tim, vendosja e filtrit gjyqësor, në rastet kur palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, kanë rregulluar çdo pasojë të shkaktuar nga zgjidhja e saj, vetëm sa ka rënduar pozitën e palëve, kanë rritur pasojat psikologjike, dhe kanë shkaktuar vonesa ligjore në rregullimin e pasojave.

Rezervat e mia në lidhje me këtë projektligj janë të lidhura me heqjen e tagrit ligjor të urdhrave të ekzekutimit Gjykatave dhe kalimit të tyre noterëve publikë dhe subjekteve juridikë. Nëse ky projektligj kalon dhe lejon që urdhrat e ekzekutimit të lëshohen nga noterët publik dhe subjektet juridike, ka disa problematika juridike që mund të lindin, përfshirë ato që lidhen me administrimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Konkretisht ndryshimet që synon të realizojë ky project ligj në nenet 510 dhe 511 mund të shkaktojë problematika si më poshtë:

Mungesa e kontrollit gjyqësor:

Një nga problemet kryesore do të ishte se noteri ose subjekti juridik që lëshon urdhrin e ekzekutimit nuk do të jetë i lidhur nga të njëjtat parime të drejtësisë dhe procedurave civile që ka një gjykatë. Gjykata ka një procedurë të plotë, me mundësi apelimi dhe me mbikëqyrje nga autoritetet më të larta të drejtësisë. Nëse ky proces kalon te noterët, mund të ketë më pak mundësi për të garantuar drejtësi dhe për të parandaluar abuzimin.

Rreziku i abuzimit me autoritetin:

Noterët dhe subjektet juridike mund të kenë interes të caktuar në një rast të caktuar, që mund të ndikojë në mënyrën se si ekzekutohet urdhri. Për shembull, mund të ndodhin abuzime me procedurat ose keqpërdorim të informacionit për të favorizuar një palë mbi tjetrën, sidomos nëse nuk ka mbikëqyrje të mjaftueshme nga një instancë gjyqësore.

Paqartësia mbi kompetencat:

Një tjetër problematikë mund të jetë krijimi i konfuzionit mbi ndarjen e kompetencave midis gjykatës dhe noterëve. Nëse noterët mund të lëshojnë urdhra ekzekutimi, ndoshta do të ketë një pasiguri të madhe për qytetarët dhe për palët e përfshira në procedurë se cilat janë të drejtat dhe mundësitë e tyre për mbrojtje ligjore.

Mbrojtja e të drejtave të palëve:

Në rastin e lëshimit të urdhrave nga një gjykatë, ka mundësi që palët të kenë mundësinë për të paraqitur prova dhe të kërkojnë mbrojtje përmes një procesi ligjor. Nëse kjo kompetencë i kalon noterëve, mund të ndodhë që

njëra palë të mbetet e pasigurt për mbrojtjen e të drejtave të saj, pasi lëshimi i urdhrit mund të jetë më i shpejtë dhe pa mundësinë për një analizë të thelluar të faktit.

Nëse kompetenca për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit i hiqet gjykatës, kjo mund të sjellë një ulje të cilësisë së procesit të drejtësisë, dhe mund të minojë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor. Gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që proceset ligjore të jenë të drejta dhe të mbrojnë të drejtat e të gjitha palëve, ndërkohë që noterët dhe subjektet juridike mund të kenë mangësi në këtë aspekt, për shkak të natyrës së punës së tyre dhe mundësisë për interes të drejtpërdrejtë.

Në përfundim, kalimi i kësaj kompetence nga gjykata te noterët dhe subjektet juridike mund të ketë pasoja të mëdha në garantimin e drejtësisë, duke rritur mundësinë për abuzime dhe duke vënë në diskutim besimin në sistemin ligjor të vendit. Përfundimisht, ndërhyrjet që synohet të bëhen në Kodin e Procedurës Civile janë të një rëndësie të madhe, por duhet të realizohen me kujdes dhe duke marrë parasysh të gjitha efektet anësore. Analiza dhe diskutimi i plotë i mundësive dhe pasojave të këtyre ndryshimeve është thelbësor për të siguruar që ato të kontribuojnë në përmirësimin drejtësisë në Shqipëri. Ndaj ky projektligj, duhet të përshkonte një rrugë më të gjatë e të gjerë, gjithëpërfshisë, të të gjithë grupeve të interesit të përfshira, për pasqyruar të gjitha pro dhe kundër, që më pas të konkludohet në ndryshime ligjore, që në focus primar të kenë dhënien e drejtësisë, dhe më pas përmbushjen e parimeve të tjera!

Bibliografia

- A.Brati “Procedura Civile” Botimet Dudaj, 2008;
- A.Simoni, S.Sadushi, S.Çomo “Veshtrim krahasues mbi Procedurën Civile”, 2006;
- A.Vorpsi, “Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, Tiranë 2011
- Y.Pjetërnikaj, I.Haxhiu, T.Punmira, “Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese mbi kodin e procedurës civile”, Tiranë 2011;
- Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar;
- Ligjit nr. 44/2021, datë 23.3.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8116 datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile i RSH”
- Projektligj Nr. __/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8116 datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile i RSH”, i ndryshuar.

Dallimet dhe pikat e përbashkëta të lidërshipt të ri dhe të vjetër në Shqipëri

Dr. c Ilir Hebovija
Universiteti Mesdhetar i Shqiperise
ilir@umsh.edu.al

Abstrakt

Ky punim shqyrton evolucionin e lidërshipt në Shqipëri, duke krahasuar liderët e hershëm demokratë me homologët e tyre modernë. Ai eksploron dallimet kryesore në fokusin e qeverisjes, stilet e lidërshipt, komunikimin publik dhe prioritetet e reformës duke identifikuar sfidat dhe qëllimet e përbashkëta. Liderët e hershëm, si Sali Berisha, u përqendruan në stabilizimin, privatizimin dhe ndërtimin e institucioneve demokratike, ndërsa liderët bashkëkohorë si Edi Rama kanë prioritet modernizimin, integrimin në BE dhe transformimin dixhital. Ky ndryshim në prioritetet e lidërshipt ka ndikuar ndjeshëm në peizazhin politik dhe ekonomik të Shqipërisë, duke formësuar zhvillimin institucional të vendit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Pavarësisht dallimeve, udhëheqësit e hershëm dhe ata të fundit janë përballur me çështje të tilla si korrupsioni, polarizimi politik dhe sfidat ekonomike. Punimi thekson gjithashtu përdorimin në rritje të mjeteve dixhitale në qeverisje dhe angazhim publik. Duke analizuar këto tendenca, ky studim ofron një kuptim gjithëpërfshirës të evolucionit politik të Shqipërisë, trajektores së saj të ardhshme drejt konsolidimit demokratik dhe integrimin evropian, si dhe sfidave që mund të lindin në këtë proces, si joefikasiteti gjyqësor dhe pabarazitë ekonomike.

Fjalët kyçe: Lidërshipt në Shqipëri, Tranzicioni Demokratik, Integrimi në BE, Qeverisja Dixhitale, Sfidat Politike, Transformimi Ekonomik, Komunikimi Publik, Reformat Kundër Korrupsionit

Abstract

This paper examines the evolution of leadership in Albania, comparing early democratic leaders with their modern counterparts. It explores key differences in governance focus, leadership styles, public communication, and reform priorities, identifying common challenges and goals. Early leaders, such as Sali Berisha, focused on stabilization, privatization, and building democratic institutions, while contemporary leaders, such as Edi Rama, prioritize modernization, EU integration, and digital transformation. This shift in leadership priorities has significantly impacted Albania's political

and economic landscape, shaping the country's institutional development and international relations. Despite their differences, both early and recent leaders have faced issues such as corruption, political polarization, and economic challenges. The paper also highlights the increasing use of digital tools in governance and public engagement. By analyzing these trends, this study provides a comprehensive understanding of Albania's political evolution, its future trajectory towards democratic consolidation and European integration, as well as the challenges that may arise in this process, such as judicial inefficiency and economic inequalities.

Keywords: Leadership in Albania, Democratic Transition, EU Integration, Digital Governance, Political Challenges, Economic Transformation, Public Communication, Anti-Corruption Reforms

Hyrje

Lidershipi në Shqipëri gjatë epokës demokratike ka shfaqur si evolucion ashtu edhe vazhdimësi ndërsa vendi ka lundruar në tranzicionin e tij nga një shtet postkomunist në një demokraci moderne. Ndërsa të gjithë liderët kanë vepruar brenda të njëjtit kornizë gjithëpërfshirëse të demokracisë, qasjet, prioritetet dhe metodat e tyre kanë ndryshuar ndjeshëm. Ky punim eksploron ndryshimet kryesore dhe të përbashkëta midis lidershipit të hershëm dhe atij më të fundit demokratik në Shqipëri, duke u fokusuar në stilet e tyre të lidershipit, sfidat dhe qëllimet e përbashkëta. Nëpërmjet një analize të detajuar të qeverisjes historike dhe moderne, ky punim synon të ofrojë një kuptim gjithëpërfshirës se si ka evoluar lidershipi dhe çfarë mësimesh mund të nxirren për trajektoren e ardhshme politike të Shqipërisë.

Konteksti historik

Pas rënies së komunizmit në fillim të viteve 1990, Shqipëria kaloi në një sistem demokratik shumëpartiak. Vitet e para të këtij tranzicioni u shënuan nga paqëndrueshmëria politike, sfidat ekonomike dhe përpjekjet për të krijuar institucione të reja. Udhëheqës të tillë si Sali Berisha, i cili shërbeu si President (1992-1997) dhe Kryeministër (2005-2013), luajtën një rol qendror gjatë kësaj periudhe formuese. Këta liderë të hershëm demokratë shpesh u përballën me sfidat e dyfishta të çmontimit të mbetjeve të sistemit komunist, ndërkohë që hodhën bazat për një ekonomi tregu dhe qeverisje demokratike.

Tranzicioni nuk ishte aspak i qetë. Vendi përjetoi trazira të konsiderueshme, veçanërisht gjatë krizës financiare të vitit 1997, e cila çoi në trazira të gjera për shkak të kolapsit të skemave piramidale në të cilat kishin investuar shumë shqiptarë. Kjo periudhë nënvizoi brishtësinë e demokracisë së hershme të

Shqipërisë dhe përgjegjësinë e pamasë të vendosur mbi udhëheqësit e saj për të stabilizuar kombin dhe për të rifituar besimin e publikut. Pavarësisht pengesave, institucionet demokratike të Shqipërisë u forcuan gradualisht, duke krijuar terrenin për më shumë sfida dhe mundësi lidërsipi bashkëkohor.

Në vitet e fundit, lidërsipi në Shqipëri është zhvendosur drejt një fokusi në modernizimin, integrimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe adresimin e çështjeve sistematike si korrupsioni dhe transparenca. Liderë si Edi Rama, kryeministër që nga viti 2013, kanë theksuar zhvillimin urban, qeverisjen dixhitale dhe transformimin kulturor, duke reflektuar nevojat dhe aspiratat në ndryshim të shoqërisë shqiptare. Ky ndryshim është nxitur nga angazhimi në rritje i Shqipërisë me organizatat ndërkombëtare dhe aspirata e saj për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, gjë që kërkon reforma thelbësore të qeverisjes.

Lidërsipi Modern në Shqipëri

Lidërsipi modern në Shqipëri gjatë epokës demokratike është formësuar nga presionet e jashtme dhe të brendshme. Udhëheqësit e hershëm demokratë shpesh theksuan stabilizimin dhe rimëkëmbjen ekonomike, ndërsa liderët më të fundit janë fokusuar në modernizimin dhe integrimin ndërkombëtar. Figurat politike në Shqipëri sot përdorin gjithnjë e më shumë teknologjinë dhe strategjitë e komunikimit për t'u angazhuar me publikun dhe për të promovuar axhendat e tyre.

Një tipar përcaktues i lidërsipit modern është prioritizimi i integritit në BE. Kjo ka nxitur reformat në qeverisje, sundimin e ligjit dhe përpjekjet kundër korrupsionit, megjithëse progresi ka qenë i pabarabartë. Për më tepër, udhëheqësit sot kanë më shumë gjasa të adoptojnë praktika pjesëmarrëse dhe transparente, duke reflektuar pritshmëritë në rritje të një elektorati të informuar. Megjithatë, sfida të tilla si polarizimi politik, pabarazia ekonomike dhe akuzat e vazhdueshme për korrupsion vazhdojnë të formësojnë peizazhin politik të Shqipërisë.

Raste studimore në përdorimin e mjeteve moderne në lidërsip

- **Edi Rama dhe Qeverisja Dixhitale:** Kryeministri Edi Rama ka qenë në krye të transformimit dixhital në qeverisje. Administrata e tij nisi platformën “e-Albania”, e cila ofron shërbime publike online, duke reduktuar joefikasitetin burokratik dhe korrupsionin. Kjo nismë ka përmirësuar aksesin për qytetarët dhe ka rritur besimin në operacionet e qeverisë.
- **Mediat sociale në fushatat politike:** Zgjedhjet parlamentare shqiptare të vitit 2021 panë një përdorim të paprecedentë të mjeteve dixhitale për mobilizimin politik. Partitë politike dhe kandidatët kanë përdorur Facebook,

Instagram dhe Twitter për t'u angazhuar me votuesit, për të paraqitur propozime politikash dhe për të luftuar dezinformimin, duke shënuar një ndryshim në strategjitë e fushatës drejt qasjeve të para dixhitale.

- Menaxhimi i Pandemisë së COVID-19: Gjatë krizës së COVID-19, qeveria shqiptare u mbështet shumë në komunikimin dixhital. Ministria e shëndetësisë dhe zyrtarët qeveritarë siguruan përditësime në kohë reale nëpërmjet mediave sociale, ndërsa mjetet dixhitale u përdorën për të koordinuar shpërndarjen e vaksinave dhe për të gjurmuar shkallët e infeksionit. Përdorimi i teknologjisë në menaxhimin e krizave ka ndihmuar në vendimmarrjen efektive dhe ndërgjegjësimin e publikut.

- Reagimi ndaj tërmetit 2019: Pas tërmetit shkatërrues në Shqipëri, agjencitë qeveritare përdorën platforma dixhitale për të koordinuar përpjekjet e ndihmës ndaj fatkeqësive. Portalet online u mundësonin qytetarëve të prekur të raportonin dëmet dhe të aplikonin për ndihmë, ndërsa mediat sociale u përdorën për të informuar publikun mbi përparimin e rimëkëmbjes dhe për të mobilizuar mbështetjen ndërkombëtare.

Miratimi i këtyre mjeteve moderne shënon një ndryshim të rëndësishëm nga metodat tradicionale të qeverisjes, duke lejuar rritjen e efikasitetit, shtrirjen më të gjerë dhe angazhimin e përmirësuar të qytetarëve. Megjithatë, sfida të tilla si dezinformata, rreziqet e sigurisë kibernetike dhe shqetësimet mbi privatësinë dixhitale mbeten fusha që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe menaxhim strategjik.

Udhëheqësit modernë shqiptarë i janë drejtuar gjithnjë e më shumë platformave dixhitale dhe mjeteve teknologjike për të shprehur dhe përforcuar lidhshkrimin e tyre. Transformimi dixhital ka luajtur një rol kyç në qeverisjen, fushatën politike, menaxhimin e krizave dhe angazhimin publik. Këto mjete kanë riformuar mënyrën se si liderët ndërveprojnë me qytetarët, rrisin transparencën dhe nxisin zbatimin e politikave. Disa nga mënyrat kryesore në të cilat teknologjia moderne përdoret në lidhshkrimin shqiptar përfshijnë:

- Angazhohuni drejtpërdrejt me qytetarët: Udhëheqësit përdorin mediat sociale për të anashkaluar kanalet tradicionale të medias dhe për të folur drejtpërdrejt me publikun. Edi Rama, për shembull, përdor shpesh Facebook-un për të shpallur politika, për të ndarë përditësime dhe për t'u përgjigjur shqetësimeve të publikut. Kjo qasje mundëson komunikim të drejtpërdrejtë, duke reduktuar mbështetjen të ndërmjetësit dhe mediat e kontrolluara nga shteti.

- Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies: Platformat dixhitale përdoren për të shfaqur progresin në projektet e infrastrukturës, reformat dhe iniciativat e tjera, duke krijuar një perceptim të llogaridhënies. Platformat si portali "e-Albania" u mundësojnë qytetarëve të aksesojnë shërbimet e qeverisë

online, duke ulur burokracinë dhe duke kufizuar mundësitë për korrupsion.

- Mobilizimi i mbështetjes dhe fushatës politike: Gjatë zgjedhjeve ose fushatave të mëdha, liderët përdorin teknologjinë për të mbledhur mbështetësit, për të përhapur mesazhet e tyre dhe për të luftuar dezinformimin. Mediat sociale, transmetimi i videos dhe reklamat dixhitale të synuara janë bërë mjete thelbësore në komunikimin politik modern.

- Nxitja e pjesëmarrjes publike dhe e-qeverisjes: Mjete të tilla si sondazhet online, seancat e drejtpërdrejta të pyetjeve dhe përgjigjeve dhe mekanizmat e reagimit lejojnë udhëheqësit të përfshijnë qytetarët në proceset vendimmarrëse, duke rritur angazhimin demokratik. Platformat e-Qeverisjes u mundësojnë qytetarëve të marrin pjesë në diskutimet e politikave dhe të kenë akses në informacion në kohë reale mbi iniciativat qeveritare.

- Menaxhimi i krizave dhe reagimi ndaj urgjencës: Roli i komunikimit dixhital u bë veçanërisht i dukshëm gjatë krizave të tilla si tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia COVID-19. Udhëheqësit përdorën platforma dixhitale për të shpërndarë informacion, për të koordinuar përpjekjet e ndihmës dhe për të garantuar sigurinë publike. Komunikimi i shpejtë përmes mediave sociale dhe portaleve qeveritare luajti një rol vendimtar në menaxhimin e këtyre emergjencave.

- Inteligjenca Artificiale dhe Analiza e të Dhënave në Qeverisje: Kohët e fundit, liderët shqiptarë kanë filluar të eksplorojnë zgjidhje të drejtuara nga AI dhe analitikë të të dhënave për të përmirësuar vendimmarrjen. Analizat parashikuese ndihmojnë në formulimin e politikave, ndërsa chatbot-et e fuqizuara nga AI përmirësojnë shërbimet e qytetarëve, duke përmirësuar efikasitetin në institucionet qeveritare.

Miratimi i këtyre mjeteve moderne shënon një ndryshim të rëndësishëm nga metodat tradicionale të qeverisjes, duke lejuar rritjen e efikasitetit, shtrirjen më të gjerë dhe angazhimin e përmirësuar të qytetarëve. Megjithatë, sfida të tilla si dezinformata, rreziqet e sigurisë kibernetike dhe shqetësimet mbi privatësinë dixhitale mbeten fusha që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe menaxhim strategjik, udhëheqësit modernë shqiptarë janë kthyer gjithnjë e më shumë në platformat dixhitale dhe mjetet teknologjike për të shprehur dhe përforcuar lidhshypin e tyre.

Udhëheqësit modernë shqiptarë i janë drejtuar gjithnjë e më shumë platformave dixhitale dhe mjeteve teknologjike për të shprehur dhe përforcuar lidhshypin e tyre. Platformat e mediave sociale si Facebook, Instagram dhe Twitter janë bërë qendrore në strategjitë e tyre të komunikimit, duke u mundësuar udhëheqësve të:

- Angazhohuni drejtpërdrejt me qytetarët: Udhëheqësit përdorin mediat sociale për të anashkaluar kanalet tradicionale të medias dhe për të folur

drejtpërdrejt me publikun. Edi Rama, për shembull, përdor shpesh Facebook-un për të shpallur politika, për të ndarë përditësime dhe për t'iu përgjigjur shqetësimeve të publikut.

- Promovimi i transparencës: Platformat dixhitale përdoren për të shfaqur progresin në projektet e infrastrukturës, reformat dhe iniciativat e tjera, duke krijuar një perceptim të llogaridhënies.

- Mobilizoni mbështetjen: Gjatë zgjedhjeve ose fushatave të mëdha, udhëheqësit përdorin teknologjinë për të mbledhur mbështetësit, për të përhapur mesazhet e tyre dhe për të luftuar dezinformimin.

- Nxitja e pjesëmarrjes publike: Mjete të tilla si sondazhet online ose mekanizmat e reagimit lejojnë liderët të përfshijnë qytetarët në proceset vendimmarrëse, duke rritur angazhimin demokratik.

Sfidat dhe Qëllimet e Përbashkëta të Liderëve të Hershëm dhe të Fundit

Pavarësisht kontekstit historik dhe ndryshimeve në sistemet politike, liderët e hershëm dhe ata modernë në Shqipëri kanë hasur në sfida të ngjashme dhe kanë ndjekur qëllime të përbashkëta. Faktorë si polarizimi politik, paqëndrueshmëria ekonomike dhe korrupsioni kanë mbetur sfida të vazhdueshme, ndërsa integrimi evropian ka qenë një objektivi i përhershëm, megjithëse i realizuar në ritme të ndryshme për shkak të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.

1. Polarizimi Politik dhe Fragmentimi i Qeverisjes

Një nga sfidat më të mëdha që ka karakterizuar si periudhat e hershme, ashtu edhe ato moderne, është polarizimi politik.

Në të kaluarën, Shqipëria ka përjetuar ndasi të thella politike që kanë penguar bashkëpunimin kombëtar. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912, vendi u përball me ndasi mes grupeve politike dhe fiseve lokale, çka e bëri të vështirë ndërtimin e një shteti të qëndrueshëm. Po ashtu, regjimet e ndryshme që pasuan, nga mbretëria e Zogut te regjimi komunist, u karakterizuan nga konfliktet e brendshme politike dhe mungesa e një demokracie funksionale.

Në kohët moderne, polarizimi politik vazhdon të jetë një pengesë kryesore për stabilitetin qeverisës. Lufta e ashpër mes partive kryesore ka krijuar një klimë mosbesimi dhe ka ndikuar në zbatimin e reformave. Shumë herë, institucionet shtetërore janë përdorur si mjete për interesa partiake, duke penguar zhvillimin e një demokracie të shëndetshme.

2. Paqëndrueshmëria Ekonomike dhe Sfida e Zhvillimit

Pavarësisht përpjekjeve të ndryshme për modernizim ekonomik, Shqipëria ka vuajtur nga periudha të gjata të paqëndrueshmërisë financiare

dhe mungesës së zhvillimit të qëndrueshëm.

Në të kaluarën, vendi ka kaluar nga një ekonomi kryesisht agrare në përpjekjet për industrializim nën regjimin komunist. Megjithatë, izolimi ndërkombëtar dhe planifikimi i centralizuar çuan në një ekonomi të dobët, e cila u rrëzua pas viteve '90.

Në kohët moderne, Shqipëria përballlet ende me sfida të mëdha ekonomike, përfshirë varësinë nga remitancat, papunësinë, informalitetin dhe investimet e pamjaftueshme në sektorët kyç. Edhe pse janë bërë përparime në zhvillimin e infrastrukturës dhe të turizmit, vendi ende nuk ka arritur një nivel të qëndrueshëm të mirëqenies ekonomike për të gjithë qytetarët.

3. Korrupsioni si Pengesë për Zhvillimin

Korrupsioni ka qenë një problem i vazhdueshëm në administratën shqiptare, si në periudhat e hershme ashtu edhe në ato moderne.

Në të kaluarën, administrata shtetërore shpesh ishte e ndikuar nga nepotizmi dhe korrupsioni, duke e bërë qeverisjen joefektive. Qeveritë e ndryshme shpesh përballëshin me akuza për keqpërdorim të fondeve publike dhe mungesë transparence.

Në ditët e sotme, pavarësisht reformave të ndërmarra, korrupsioni mbetet një nga sfidat kryesore. Shqetësime të mëdha ngrihen në lidhje me drejtësinë, prokurimet publike dhe ndikimin e interesave private në politikë. Megjithëse janë ndërmarrë përpjekje për të forcuar institucionet e drejtësisë, niveli i korrupsionit vazhdon të jetë një pengesë për zhvillimin dhe për afrimin me Bashkimin Evropian.

4. Integrimi Evropian – Një Objektiv i Përbashkët me Ritme të Ndryshme

Një nga synimet e përbashkëta të qeverive shqiptare ka qenë afrimi me Evropën dhe përfshirja në organizata ndërkombëtare.

Në të kaluarën, edhe pse Shqipëria ishte një vend i izoluar në pjesën më të madhe të shekullit XX, përpjekjet për njohje dhe bashkëpunim ndërkombëtar ishin prezente. Në periudhën e pas-pavarësisë, qeveritë shqiptare kërkonin mbështetje nga fuqitë e mëdha për të siguruar sovranitetin dhe zhvillimin e vendit.

Në kohët moderne, integrimi në Bashkimin Evropian ka qenë një prioritet kryesor për qeveritë shqiptare, por progresi ka qenë i pabarabartë. Pavarësisht disa reformave në drejtësi dhe administratë publike, shqetësimet mbi sundimin e ligjit, korrupsionin dhe lirinë e medias kanë ngadalësuar përparimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE. Faktori gjeopolitik gjithashtu ka luajtur një rol, me ndikimet e krizave ndërkombëtare dhe qëndrimet e vendeve anëtare të BE-së që kanë ndikuar në këtë proces.

Konkluzione

Evolucioni i lidershipit demokratik në Shqipëri pasqyron rrugëtimin e vazhdueshëm të vendit drejt modernizimit, integritit dhe qëndrueshmërisë. Që nga vitet e para të tranzicionit postkomunist në qeverisjen e sotme të lidhur në mënyrë dixhitale, stilet e lidershipit janë përshtatur për të përmbushur sfidat dhe aspiratat në ndryshim të shoqërisë shqiptare. Liderë si Sali Berisha, i cili u fokusua në stabilizimin dhe ndërtimin e institucioneve, hodhën bazat për qeverisjen demokratike. Ndërkohë, figura bashkëkohore si Edi Rama kanë përqafuar modernizimin, duke i dhënë përparësi zhvillimit urban, shtrirjes në BE dhe transformimit dixhital.

Pavarësisht këtyre dallimeve, fijet e përbashkëta përshkojnë historinë e lidershipit demokratik të Shqipërisë. Sfida të tilla si korrupsioni, polarizimi politik, reforma ekonomike dhe diplomacia rajonale kanë mbetur qendrore, duke kërkuar elasticitet dhe përshtatje nga udhëheqësit gjatë dekadave. Si liderët e hershëm ashtu edhe ata të fundit ndajnë një angazhim për integritimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, megjithëse progresi ka qenë i pabarabartë dhe i formësuar nga strategji dhe rrethana të ndryshme.

Mjetet moderne dhe platformat dixhitale janë shfaqur si tipare përcaktuese të lidershipit të kohëve të fundit, duke mundësuar një angazhim më të madh publik, transparencë dhe pjesëmarrje. Përdorimi i mediave sociale nga Edi Rama dhe platformës “e-Albania” ilustron se si teknologjia mund të përmirësojë qeverisjen, ndërsa përshtatja e Sali Berishës me komunikimin dixhital nxjerr në pah vazhdimësinë e ndikimit në një peizazh në ndryshim. Rastet studimore, të tilla si përgjigjet ndaj krizës së skemave piramidale të vitit 1997, tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë COVID-19, ilustrojnë më tej sesi liderët shqiptarë i kanë lundruar krizat me elasticitet. Këto momente nënvizojnë përshtatshmërinë dhe vendosmërinë e nevojshme për të udhëhequr kombin nëpër periudha pasigurie.

Për më tepër, lidershipi modern në Shqipëri është fokusuar në projektet e rinovimit urban, reformat gjyqësore për t’iu përshtatur standardeve të BE-së, modernizimin ekonomik nëpërmjet investimeve të huaja dhe përpjekjet e diplomacisë rajonale, si nisma e Ballkanit të Hapur. Shtytja për qeverisjen dixhitale, inteligjencën artificiale dhe politikëbërjen e drejtuar nga të dhënat demonstroi zhvendosjen drejt një strukture qeveritare më efikase dhe transparente.

Ndërsa Shqipëria vazhdon rrugëtimin e saj demokratik, mësimet e lidershipit të hershëm dhe atij modern do të jenë kritike. Reformat e vazhdueshme, transparenca dhe qeverisja me në qendër qytetarin do të mbeten thelbësore në ndërtimin e besimit dhe nxitjen e progresit të qëndrueshëm. Duke shfrytëzuar pikat e forta të trashëgimisë së saj të lidershipit, ndërkohë

që adreson sfidat e vazhdueshme, Shqipëria mund të vazhdojë rrugën e saj drejt një të ardhmeje më gjithëpërfshirëse, moderne dhe më të integruar. Që nga vitet e para të tranzicionit post-komunist në qeverisjen e sotme të lidhur dixhitalisht, stilet e lidërshiptit janë përshtatur për të përmbushur sfidat dhe aspiratat në ndryshim të shoqërisë shqiptare. Liderë si Sali Berisha, të cilët u fokusuan në stabilizimin dhe ndërtimin e institucioneve, hodhën bazat për qeverisjen demokratike. Ndërkohë, figura bashkëkohore si Edi Rama kanë përqafuar modernizimin, duke i dhënë përparësi zhvillimit urban, shtrirjes në BE dhe transformimit dixhital.

Pavarësisht këtyre dallimeve, fjetet e përbashkëta përshkojnë historinë e lidërshiptit demokratik të Shqipërisë. Sfidat si korrupsioni, polarizimi politik dhe reforma ekonomike kanë mbetur qendrore, duke kërkuar elasticitet dhe përshtatje nga udhëheqësit gjatë dekadave.

Referenca:

Abrahams, F. (1996). *Human Rights in Post-Communist Albania*. Human Rights Watch.

Biberaj, E. (1999). *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*. Westview Press.

Krasniqi, A. (2020). *Political Transformation in Albania: From Communism to Democracy*. Albanian Journal of Politics.

Noutcheva, G. (2012). *European Foreign Policy and the Challenges of Balkan Accession*. Routledge.

Rama, E. (2019). *Modernizing Albania: A Vision for the Future*. Tirana Press.

Smith, J. (2021). *Digital Governance and Leadership in Southeast Europe*. Cambridge University Press.

Brown, L. (2022). *Political Challenges in Albania's EU Integration*. Oxford Political Review.

Taylor, R. (2023). *The Role of Social Media in Political Engagement in the Balkans*. Palgrave Macmillan.

Rregullimi i kohëzgjatjes së orarit të punës në Itali. Qasje normative dhe jurisprudenciale.

Julian Çollaku PhD
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
julian.collaku@umsh.edu.al

Abstrakt

Rregullimi normativ i kohëzgjatjes së orarit të punës, si një ndër elementët kryesor të kontratës individuale të punës, ka tërhequr vëmendjen e aktorëve të së drejtës, dhe jo vetëm, prej fundit të shekullit XVIII, duke arritur në fillimin e shekullit të XX të gjejë një rregullim në nivel ndërkombëtar nëpërmjet aktivitetit të Organizatës ndërkombëtare të punës, që sapo kishte filluar aktivitetin e saj.

Zhvillime të mëtejshme ligjvënëse kemi gjithashtu në rang të Bashkimit Europian me direktivat nn. 93/104; 2003/88, tek të cilat kohëzgjatja e orarit të punës gjen një rregullim normativ rinovues dhe të strukturuar, në kërkim të një ekuilibri të ri mes fleksibilitetit të formave të reja të punës dhe nevojës së garantimit të tutelave mbrojtëse ndaj shëndetit dhe jetës private, personale dhe familjare të punëmarrësit, që do të integrohej më tej gradualisht brenda vendeve anëtare.

Punimi synon të analizojë zhvillimet legjislativë mbi kohëzgjatjen e orarit të punës në Itali, nga dekreti mbretëror i vitit 1923 tek dekreti legjislativ n. 66/2003, duke u ndalur në menyrë specifike mbi nivelin e implementimit të normativës europiane dhe respektimin e qëllimeve të saj, problematikat e legjitimitetit kushtetues të normativës së re, trajtimin e instituteve specifike që përbëjnë këtë normativë, si edhe kompetencat dhe rolin e autonomisë kontraktuale kolektive dhe individuale në arritjen e rezultateve të parashtruara nga normativa në fuqi.

Fjalët kyçe: punë; kohëzgjatje; orari; shëndeti; jeta private; punëmarrësi; koha shtesë; pushimet; puna e natës; Itali.

Abstract

The legislative regulation of the duration of working time, as one of the main elements of the individual employment contract, has attracted the attention of legal actors, and not only, since the end of the XVIII century, reaching at the beginning of the XX century an international regulation through the activity of the International Labor Organization (ILO), which had just begun its activity.

Further legislative developments has been made at the European Union level with directives nn. 93/104; 2003/88, in which the duration of working time regulation finds a renewal and structured adjustment, in search of a new balance between flexibility of new forms of work and need to guarantee protective tutelages to health and private life of employees.

The paper aims to analyze the legislative developments on the duration of working time in Italy, from the royal decree of 1923 to the legislative decree n. 66/2003, focusing specifically on the level of implementation of the European law and respecting its objectives, the problems of constitutional legitimacy of the decree n. 66/2003, the discussion of specific institutes contained in regulations, as well as the competencies and role of collective bargaining and individual autonomy in achieving the results set out in the applicable norms.

Keywords: working time; employee private life; safety and health; overtime; rest periods; annual leave; night time; Italy.

1. Dekreti legjislativ n. 66/2003, respektimi i disiplinës normative europiane dhe impakti në legjislationin kombëtar.

Aktualisht kohëzgjatja e orarit të punës në marrëdhënien juridike individuale të punës në Itali është e rregulluar nëpërmjet dekretit legjislativ n. 66/2003¹, i cili përshtat legjislationin e brendshëm në këtë aspekt me kërkesat dhe parashikimet minimale të përmbajtura në direktivat e Bashkimit European n. 93/104 dhe n. 2000/34².

Në periudhën që paraprin ndërhyrjen normative të vitit 2003, aspektet kryesorë të kohëzgjatjes së orarit të punës ishin të përmbledhura në dekretin normativ mbretëror n. 692 të 15 marsit 1923, i cili përcaktonte orarin maksimal normal të punës në 8 orë ditore dhe 48 orë javore, duke përcaktuar fushat e zbatimit dhe efektshmërisë së normativës në fjalë si edhe kushtet e përdorueshmërisë së orëve të punës shtesë dhe limitin maksimal të tyre që mund t'i kërkoheshin një punëmarrësi specifik. Për vendosjen në zbatim në mënyrë të plotë të dekretit të vitit 1923 do të dilnin më pas një sërë normash rregulluese të orëve maksimale të kohës së punës që do ti referoheshin punëmarrësve të punësuar në sektorët e industrisë dhe tregtisë (dekret-ligj mbretëror n. 1955 i datës 10 shtator 1923).

Panorama normative e kohëzgjatjes së orarit të punës nuk do të pësonte ndryshime me hyrjen në fuqi të Kodit civil italian (16 mars 1942) i cili, edhe pse i dedikon këtij aspekti nenet 2107, 2108 dhe 2109, i'a delegon rregullimin

1 Dekreti në fjalë ka patur në vijim disa ndryshime nëpërmjet dekretit legjislativ n. 213/2004, të cilat do të trajtohen përgjatë këtij punimi si pjesë integruese e dekretit fillestar.

2 Direktivat janë zëvendësuar në vijim nga direktiva kodifikuese n. 2003/88 e cila ka riorganizuar aspektet strukturore të normativës komunitare.

specifik të kohëzgjatjes ditore dhe javore të orarit të punës ligjeve speciale mbi këtë çështje; parashikon në mënyrë të përgjithshme të drejtën për shtesat mbi pagë në lidhje me orët shtesë dhe punën e zhvilluar gjatë orëve të natës; si edhe kryen një parashikim të zgjeruar dhe të përgjithshëm mbi të drejtën e punëmarrësit për pushimet ditore, javore dhe vjetore.

Në vijmësinë kronologjike edhe Kushtetuta e vitit 1948, nëpërmjet nenit 36, konfirmonte delegimin të normat ligjore të rregullimit dhe përcaktimit të limiteve mbi kohëzgjatjen maksimale të orarit të punës dhe parashikonte gjithashtu të drejtën e patjetërsueshme të punëmarrësit për pushime javore dhe vjetore të paguara.

Duke u rikthyer, pas këtij *excursus*-i të shkurtër normativ, te dekreti legjislativi i vitit 2003 i cili zbaton kërkesat institucionale europiane mbi rregullimin e kohëzgjatjes së orarit të punës, duhet thënë se ky i fundit është rezultati i një rrugëtimi të filluar qysh gjatë vitit 1997, nëpërmjet nënshkrimit të akordit ndërkonfederativ sindikal, i cili do të riaktivizohej për realizimin e detyrave europiane përgjatë vitit 2001. Ndërkohë që edhe legjislatori italian kishte dhënë prova përshtatjeje të normativës rregulluese kundrejt direktivave europiane me miratimin e ligjit n. 196 të 24 qershorit 1997, i cili nëpërmjet nenit 13 sillte disa ndryshime të rëndësishme në disiplinën e orarit të punës³. Ndër këto mund të përmendet kufizimi i kohëzgjatjes normale javore të punës në 40 orë si edhe mundësia e deleguar ndaj autonomisë kolektive për të përcaktuar një kohëzgjatje më të ulët të orarit javor dhe përlllogaritja e këtij të fundit në mënyrë mesatare për periudha referuese që mund të shkonin nga më shumë se një javë deri në 12 muaj. Reforma të tjera ndërkohë kishin prekur gjithashtu rregullimin e disiplinës së orëve shtesë në sektorin e industrisë dhe disiplinën e punës së kryer gjatë orëve të natës⁴.

Sa më lart, ju referohemi disa ndryshimeve legjislative të cilat kishin ndryshuar në mënyrë domethënëse kornizën normative paraekzistuese, duke kërkuar të arrinin një përshtatje të asetit normativ kombëtar italian me parametrat e parashtrura nga direktivat komunitare.

Sidoqoftë, procesi i jetësimit të kërkesave të lartpërmendura karakterizohej nga një *“fragmentizim i theksuar dhe ndërhyrjet normative nuk ishin domosdoshmërisht të ndërlihdhura mes tyre në mënyrë racionale”*⁵. Kjo sepse, nga njëra anë, legjislatori kombëtar italian nuk iu ishte përshtatur disa kërkesave konkrete të direktivave europiane që lidheshin me pushimet gjatë aktivitetit ditor të punës dhe, nga ana tjetër, sepse ndërhyrjet e njëpasnjëshme kishin

3 FERRANTE V., *Nuova disciplina dell'orario di lavoro, "Il 'pacchetto Treu'"*, NAPOLI M., *Nuove leggi civ. comm.*, 1998, ff. 1305-1325.

4 FERRANTE V., *La nuova legge tema di lavoro straordinario, Nuove leggi civ. comm.*, 1999, ff. 799-820. FERRANTE V., *La disciplina del lavoro notturno, Nuove leggi civ. comm.*, 2000, ff. 534-555.

5 TIRABOSCHI M., RUSSO A., *Prime osservazioni sull'attuazione della direttiva n. 93/104/Ce,*

sjellë një shfuqizim eksplisit të normativës së vitit 1923 duke sjellë probleme të theksuara të koordinimit mes normave dhe përcaktueshmërisë së drejtë të normës së zbatueshme në rastet konkrete dhe specifike⁶. Nga ana tjetër nuk mund të mendohej se akordi ndërkonfederativ i vitit 1997 do të bënte të mundur një pasqyrim të plotë të përmbajtjes së direktivës europiane, duke qenë se, sikurse ishte shprehur edhe Gjykata e drejtësisë e Bashkimit Europian, akordi në fjalë i referohej vetëm sektorit të industrisë⁷. Gjithashtu (dhe për më tepër), një pasqyrim normativ kombëtar me autorësinë e përfaqësive ndërkonfederative nuk mund të kthehej në rregullues i përgjithshëm i çështjeve mbi kohëzgjatjen e orarit të punës duke mbajtur parasysh zbatueshmërinë relative të akordeve sindikale në realitetin italian.

Tentativat e një akordi të përgjithshëm mes palëve sociale u rinovuan sërish në vitin 2002, me ftesë të qeverisë italiane, por mungesa e një dakortësie të re mes tyre dhe presioni i ushtruar nga autoritetet komunitare bindën përfundimisht ekzekutivin fqinj të ndërmerre iniciativën autonome në propozimin e një drafti paraprak, i cili do të shndërrohej në dekretin legjislativ ekzekutues të vullnetit europian.

Arrihej në këtë mënyrë në një dispozitë normative organike dhe të strukturuar që realizonte përfundimisht përshtatjen e legjislacionit të brendshëm në lidhje me kohëzgjatjen e orarit të punës, kundrejt parashikimeve të legjislatorit europian, edhe pse përmbajtja nuk kaloi pa kritika, të cilat i referoheshin kryesisht mos respektimit të *non-regression clause*, që ndalon përdorimin e përshtatjes së legjislacionit kombëtar kundrejt atij europian si shkak për të përkeqësuar nivelin garantues të së drejtës vendase. Përqëndrimi i tyre kryhej mbi mangësinë e kufirit ligjor të përdorimit të orëve shtesë ditore dhe javore, duke ulur nivelin e garancive kundrejt normativës paraekzistuese, dhe forcohej edhe më tepër nga mos parashikimi në normativën e re të kohëzgjatjes maksimale ditore të kohës së punës, të kufirit ligjor maksimal të javës së punës të konsideruar në vetvete, të përlllogaritjes mesatare të zgjatjes së punës të nates, etj⁸.

Probleme të tjera dhe më serioze lindnin nga një përplasje e mundshme legjitimiteti kushtetues i dekretit në fjalë, ku sipas një pjese të doktrinës parashikimi indirekt i kohëzgjatjes maksimale ditore të punës, duke përcaktuar një pushim prej jo më pak se 11 orësh të njëpasnjëshme çdo 24 orë, nuk respekton parimin kushtetues të përmbajtur në nenin 36, pika 2. Ky i

Guida lav., 2003, n. 17, f. 12.

6 *Ibidem*

7 Mbi arsyetimin e vendimit të GJDBE: RICCI G., *Orario di lavoro: la condanna della Corte di Giustizia Ue*, Guida lav., 2000, n. 17, ff. 17-19.

8 LECCESE V., *La disciplina dell'orario di lavoro nel d. lgs. n. 66/2003, come modificato dal d. lgs. n. 213/2004*, www.lex.unict.it, ff. 9-11. LECCESE V., *L'orario di lavoro. La normativa italiana di attuazione delle direttive comunitarie*, IPSOA, 2004, ff. 6-11.

fundit, sipas doktrinë, “ka për qëllim të shmangë në mënyrë të drejtpërdrejtë një zgjatje të orarit të punës dëmtues për shëndetin dhe jetën private dhe familjare të punëmarrësit, ndërsa parashikimi i dekretit synon një periudhë minimale dhe të përshtatshme pushimi në një hark kohor të lëvizshëm prej 24 orësh”⁹.

2. Qëllimi, përkufizimet dhe fusha e zbatimit e dekretit legjislativ n. 66/2003.

Në lidhje me qëllimet e dekretit legjislativ në fjalë, mund të thuhet se dispozitat që përmbahen në këtë akt bëjnë të mundur rregullimin në mënyrë të njëtrajtshme brenda territorit kombëtar të aspekteve të ndryshme të disiplinës së raportit të punës që lidhen me organizimin e kohëzgjatjes së orarit të punës, në respektimin e plotë të autonomisë kolektive. Bie në sy fakti se objektivi i normativës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me organizimin e orarit të punës dhe jo me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në marrëdhënien e punës të punëmarrësit, të cilat përbëjnë qëllimet kryesore të direktivave europiane që rregullojnë në mënyrë specifike kohëzgjatjen e orarit të punës. Zgjedhja e kryer nga ligjvënësi italian bën sens duke qenë se aspektet e sigurisë dhe shëndetit në punë mund të sillnin përplasje në fushën e ndarjes së kompetencave mes pushtetit qendror dhe atij rajonal, duke qenë se garantimi i shëndetit në përgjithësi ndahen pikërisht mes këtyre dy pushteteve, ndërsa duke i dhënë përparësi emërtimit mbi rregullimin e kohëzgjatjes së orarit të punës, për pasojë konsiderimin e kësaj çështjeje si kompetencë ekskluzive qendrore anashkalohen dhe paraprihen konflikte potenciale mes dy niveleve të pushtetit¹⁰.

Përsa i përket përkufizimeve të përmbajtura në nenin 1, pika 2, interes të veçantë përmban ai i orarit të punës, sipas së cilit mund të konsiderohet si i tillë “çdo periudhë kohore në të cilën punëmarrësi është në punë, në dispozicion të punëdhënësit dhe në ushtrimin e aktivitetit ose të funksioneve për të cilat është punësuar”, përkufizim nga i cili deduktohet qartë nevoja e ekzistencës së njëkohëshme të të trija aspekteve për të bërë të mundur realizimin e llogaritjes të njësisë kohore si pjesë e kohëzgjatjes së orarit të punës¹¹. Ky përkufizim bën të mundur gjithashtu tejkalimin përfundimtar të përkufizimit të mëparshëm të orarit të punës si ajo pjesë e kohës që i dedikohet “punës efektive”, pra me përjashtimin e atyre periudhave kohore në të cilat punëmarrësi edhe pse ndodhet në vendin e punës nuk ishte duke ushtruar aktivitetin e vet¹², që

9 LECCESE V., *L'orario di lavoro tra ordamento terno e disciplina comunitaria*, Nuove leggi civ. comm., 2004, II, f. 1329.

10 TIRABOSCHI M., RUSSO A., cit. f. 14. LAI M., *Nuova disciplina del tempo di lavoro e tutela della salute e della sicurezza: riflessioni sul d. lgs., n. 66/2003*, Riv. It. Dir. Lav., 2004, I, ff. 67-68.

11 FRANCI R., *L'orario di lavoro e le modalità della prestazione*, Lav. prev. oggi, 2003, f. 794. LAI M., cit. f. 68. Gjithashtu vendimi GJDBE 3/10/2000 (C-303/98), Guida lav., 2001, n. 2, f. 10.

12 Në këtë mënyrë puna efektive cilësohet nga zhvillimi i një aktiviteti të vazhdueshëm dhe ngulmues; TIRABOSCHI M., RUSSO A., cit. f. 16.

përmbahej në normativën e vitit 1923 dhe ishte rimarrë edhe nga akordi ndërkonfederativ i vitit 1997.

Në lidhje me fushën e zbatimit normativa e vitit 2003 kap një spektër më të gjerë në krahasim me atë të vitit 1923, duke qenë se tanimë parashikimet normative gjejnë zbatim gati në të gjithë sektorët e aktiviteteve publike dhe private, me përjashtimin e sektorëve të punësimit në det, të personelit të aviacionit civil, të mbrojtjes civile, si edhe të personelit që ushtron aktivitetin e punës pranë strukturave gjyqësore, të vuajtjes së dënimit, të rendit publik, etj. në fushën e zbatimit të dekretit hyjnë gjithashtu edhe marrëdhëniet e punës të lidhura me mësimin e profesionit të personat mbi 18 vjeç, duke eliminuar në mënyrë përfundimtare kufizimet mbi orarin maksimal dhe punën e natës për këta punëmarrës, vendim-marrje nga ana e legjislatorit që gjen justifikim në rritjen e vazhdueshme të moshës për të aksesuar këtë marrëdhënie pune specifike (aktualisht në Itali moshë maksimale e mësimit të profesionit është 29 vjeç)¹³.

3. Kohëzgjatja normale dhe maksimale e orarit të punës. Orët shtesë.

Rregullimi i kohëzgjatjes normale dhe maksimale të orarit të punës i përmbajtur në dekretin zbatues të direktivës europiane përmbledh në vetvete hapësirat e krijuara nga kjo fundit dhe nga parashikimet e ligjit n. 196/1997 drejt një administrimi fleksibël të kohëzgjatjes të orarit të punës¹⁴.

Në lidhje me dualizmin terminologjik orar normal dhe orar maksimal duhet saktësuar se kemi të bëjmë me orar normal në të gjitha ato raste në të cilat aktiviteti i punës, në lidhje me kohëzgjatjen e tij, kryhet brenda një kuadri të rregullt dhe të perseritur në kohë të cilit i përket një pagese normale, ndërsa me orar maksimal të punës nënkuptohet ai kufi kohëzgjatjeje përtej të cilit nuk është e mundur kryerja e aktivitetit të punës, kryesisht për arsye të mbrojtjes së shëndetit të punëmarrësit, i cili nuk duhet t'i nënshtrohet një stresi fizik dhe psikologjik përtej një limiti të caktuar. Në këtë mënyrë, të ndryshme janë edhe pasojat e tejkalimit të dy limiteve të sipercituar. Nga njëra anë tejkalimi i kufirit normal të kohëzgjatjes së orarit, por brenda atij maksimal, sjell një rritje të detyrimit ekonomik nga ana e punëdhënësit, ndërsa, nga ana tjetër, tejkalimi i kufirit maksimal sjell një detyrim dëmshpërblimi në favor të punëmarrësit për përdorim të tepruar të energjive të tij psiko-fizike¹⁵.

Sa i përket kohëzgjatjes së aktivitetit të punës, duke iu referuar nenit 3 të dekretit, evidentohet mungesa e përcaktimit në mënyrë të drejtpërdrejtë e orarit normal të ditës së punës, aspekt i cili dilte në pah si në rregullimin e përmbajtur në direktivën europiane, ashtu edhe në akordin ndërkonfederativ

13 FRANCI R., *cit.* ff. 784-785.

14 LAI M., *cit.* f. 72.

15 FRANCI R., *cit.* ff. 800-801.

të vitit 1997 dhe në nenin 13 të ligjit n. 96/1997, duke tejkaluar në këtë mënyrë përfundimisht parashikimet e normës së vitit 1923 e cila fliste për kohëzgjatje normale të ditës së punës në 8 orë. Sidoqoftë, nëpërmjet një deduksioni logjik, duke u nisur nga parashikimi i nenit 7 i cili flet për të drejten e pushimit ditor nga ana e punëmarrësit në 11 orë ditore të vazhdueshme çdo 24 orë, mund të arrihet në konkluzionin se kohëzgjatja maksimale ditore e lejuar nga dekreti në fjalë është 13 orë ditore¹⁶.

Në vijim neni 3 përcakton kohëzgjatjen normale javore të orarit të punës në 40 orë, duke parashikuar për akordet kolektive mundësinë e rregullimit të një kohëzgjatjeje më të ulët ose të përlllogaritjes së saj në mënyrë mesatare për një periudhë referuese jo më shumë se 12 muaj për nevoja organizuese specifike. Ndërsa kohëzgjatja maksimale javore e orarit të punës është e rregulluar nga neni 4, i cili qysh në fillimin e vet iu delegon akordeve kolektive përcaktimin e orëve maksimale, duke shtuar me tej (pika 2) se sidoqoftë ky limit nuk mund të jetë përtej 48 orëve për periudha 7 ditore, duke përfshirë në këtë limit edhe orët shtesë të kryera nga punëmarrësi. Akordet kolektive kanë pra lirinë e përcaktimit të orarit maksimal javor brenda këtij limiti maksimal dhe mund t'a ndryshojnë këtë limit vetëm në sens ngushtues. Duke shkuar më tej, nga leximi i pikës 4, deduktohet se edhe ky kufizim maksimal i caktuar nga norma nuk është gjithsesi absolut, duke qenë se mund të përlllogaritet si një mesatare orësh të punuara për periudha referuese të cilat nuk mund të jenë më të gjata se 4 muaj, dhe liria e kësaj përlllogaritjeje i përket punëdhënësit, i cili mund të akordohet me punëmarrësin brenda mundësive të lejuara nga akordet kolektive të zbatueshme. Nga ana tjetër periudha 4 mujore e përlllogaritjes mund të zgjerohet deri në 6 ose 12 muaj nëpërmjet akordeve kolektive përballe ekzistencës së nevojave objektive, teknike ose që lidhen me organizimin e punës dhe duhen përcaktuar qartësisht brenda akordeve kolektive.

Rezulton pra që kufiri maksimal i 48 orëve javore mund të tejkalohet nëpërmjet hapësirave ligjore dhe kolektive, duke mundësuar brenda një periudhe referuese prej 4 muajsh realizimin e javëve të punës edhe me 78 orë, duke u mjaftuar që në pjesë të caktuara të 4 mujorit të aplikohen orare më të ulëta se 48 orë në mënyrë të tillë që të ruhet mesatarja maksimale e orëve javore¹⁷. Detyrimi i vetëm i parashikuar për punëdhënësin është ai i komunikimit së periudhës referuese, brenda së cilës do të kryhet përlllogaritja mesatare e kohëzgjatjes, te drejtoria përkatëse e inspektoratit të punës .

Në lidhje me rregullimin e orëve shtesë, nën aspektin kronologjik instituti në fjalë kishte gjetur një sistemin me normativën fillestare të vitit 1923, e cila

¹⁶ TIRABOSCHI M., RUSSO A., *cit.* f. 20, LAI M., *cit.* f. 85, DEL PUNTA R., *La riforma dell'orario di lavoro, Dir. Prat. Lav.*, 2003, n. 22, f. XIV.

¹⁷ DEL PUNTA R., *cit.* f. XIII.

parashikonte mundësinë e tejkalimit të orarit normal ditor nëpërmjet akordit mes palëve për jo më të për se 2 orë ditore dhe 12 orë javore dhe këto orë duhet të përlllogariteshin në mënyrë të veçuar nga pjesa tjetër e orarit të punës dhe duhet të paguheshin me një shtesë mbi pagë jo më pak se 10% i pagës bazë orare. Një pjesë e parashikimeve të mësipërme ruhej edhe nga akordi i vitit 1997, i cili duke përkufizuar orët shtesë si ajo pjesë e orarit të punës që tejkalon orët normale, përcaktonte përlllogaritjen e veçuar dhe shtesën mbi pagë, ndërsa shfuqizonte kufizimet ditore dhe javore të përdorimit të orëve shtesë duke rivendosur një kufi maksimal prej 250 orësh vjetore shtesë dhe 80 orë për tremujor, duke konfirmuar nevojën e akordit mes palëve, përveç rasteve në të cilat akordet kolektive mund të vendosnin limite të ndryshme mbi numrin maksimal të orëve shtesë.

Dekreti i vitit 2003 rinovon në pjesën më të madhe rregullimin normativ të orëve shtesë, duke filluar nga përkufizimi i tyre si ato orë pune të cilat kryhen përtej orarit normal javor të punës prej 40 orësh, i cili sikurse u tha më lart, me nderhyrjen e akordeve kolektive, mund të përlllogaritet si mesatare në periudha referuese 4 mujore. Neni 5 i dekretit përcakton se përdorimi i orëve shtesë duhet të jetë “i kontrolluar dhe i përmbajtur”, duke i dhënë përparësi në këtë mënyrë mbrojtjes së shëndetit së punëmarrësit, aspekt ky i konfirmuar jo vetëm nga doktrina por edhe nga disa vendime të rëndësishme të pushtetit gjyqësor¹⁸. Në vijim normativa e 2003-it ia delegon akordeve kolektive detyrën e rregullimit dhe përdorimit të orëve shtesë, brenda limiteve maksimale të kohëzgjatjes javore të orarit të punës; shtesën e pagës për orët shtesë të kryera ose në mënyrë alternative mundësinë e përfitimit të pushimeve javore kompensuese; ndërkohë që përdorimi dhe kryerja e orëve shtesë është e mundur edhe në ato raste në të cilat mungojnë akordet kolektive, nëpërmjet akordit mes palëve dhe për jo më shumë se 250 orë vjetore¹⁹.

Sa i përket, në përfundim, aspekteve procedurale për përdorimin e orëve shtesë, normativa parashtron për punëdhënësin detyrimin e komunikimit në të gjitha ato raste në të cilat kalohet limiti i 48 orëve javore nëpërmjet përdorimit të orëve shtesë. Si pasojë njësitë produktive që punësojnë mbi 10 punëmarrës kanë detyrimin informues brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit referues pranë Drejtorisë përkatëse të Inspektoratit të punës.

4. Pushimi i ndërmjetëm, pushimet ditore, javore dhe vjetore.

Normativa përcakton një rregullim specifik dhe gjithpërfshirës në lidhje me pushimet e ndërmjetme, duke përbërë një risi për këtë institut, i cili më herët ekzistonte vetëm për disa kategori të caktuara punëmarrësish. Parashikime

¹⁸ LAI M., cit. f. 82. GJL 1.9.1997, n. 8267, *Mass. Giur. Lav.*, 1997, ff. 818-826; GJL 5.2.2000, n. 1307, *Dir. rel. ind.*, 2000, ff. 389-393.

¹⁹ LECCESE V., cit. f. 42.

të kësaj natyre iu referoheshin minoreneve, të cilët kishin të drejtën e një orë pushimi të ndërmjetëm nëse zgjatja e aktivitetit ditor të punës tejkalonte 4 orët, si edhe punëmarrësve të videoterminalëve, për të cilët parashikohej detyrimi i një pushimi prej 15 minutash çdo dy orë punë. Në lidhje me pjesën tjetër të sektorëve dhe punëmarrësve rregullimi i pushimit të ndërmjetëm i delegohej veprimtarisë së përfaqësive kolektive, ndërkohë një rol parësor iu rezervohet këtyre të fundit edhe nga dekreti i vitit 2003.

Sipas përmbajtjes së normativës të vitit 2003, nëse orari ditor tejkalon në zgjatjen e tij kufirin e 6 orëve punëmarrësi duhet të përfitojë një pushim të ndërmjetëm, sipas rregullave të caktuara nga kontratat kolektive, me qëllim shpłodhjen, rekuperimin e energjive psiko-fizike, shkëputjen nga aktiviteti monoton, si edhe për të plotësuar nevojat e ushqyerjes. Në mungesë të përcaktimeve nga ana e akordeve kolektive, nëni 8 parashikon mundësinë e një pushimi minimal jo më pak se 10 minuta i cili mund të ushtrohet edhe në vendin e punës, brenda kohëzgjatjes ditore të punës (jo në fillim ose përfundim të aktivitetit ditor, duke qenë se në këtë mënyrë nuk do të realizoheshin qëllimet e këtij lloji pushimi²⁰) dhe duke mbajtur parasysh nevojat teknike dhe organizuese të procesit të punës.

Pushimi ditor rregullohet nga nëni 7, i cili specifikon se kohëzgjatja e pushimit në fjalë duhet të jetë prej 11 orësh të vazhdueshme çdo 24 orë, por mund të jepet edhe në mënyrë të pjesëshme për ato aktivitete pune të cilat karakterizohen nga fraksione të ndryshme të aktivitetit përgjate ditës. Mundësi përjashtuese ndaj rregullave të kohës së pushimit ditor i njihen akordeve kolektive, të cilët mund të arrijnë parashikime të ndryshme pa nevojën e kushteve objektive, duke ndërhyrë në zgjatjen e pushimit dhe vazhdueshmërinë e tij, por duke i garantuar punëmarrësit periudha të njëjta pushimi kompensuese ose, në ato raste kur ky pushim nuk është i mundur, të realizojë një mbrojtje të përshtatshme.

Nëpërmjet nenit 9 parashikohet e drejta e punëmarrësit për pushimin javor prej së paku 24 orësh të vazhdueshme brenda një periudhe prej 7 ditësh, të cilit i shtohen 11 orët e pushimit ditor, dhe duhet të përkojë si rregull me ditën e diel. Aspekti i fundit solli një sërë protestash nga ana e përfaqësive së punëdhënësve, të cilët kontestonin mosrespektimin e frymës së direktivës n. 2000/34 e cila e kishte eliminuar në mënyrë definitive këtë parim²¹.

Përjashtime nga rregullat e kohëzgjatjes dhe momentit në të cilin pushimi javor duhet të kryhet janë të parashikuara për një sërë kategorish punëmarrësish të cilët e kryejnë aktivitetin e tyre me turne, në mënyrë të fraksionuar ose që punojnë në sektorin e trasporteve, ndërkohë që një fuqi deroguese e

20 LECCESE V., *cit.* f. 61; FRANCI R., *cit.* f. 813.

21 Mbi këtë çështje është shprehur edhe Gjykata e drejtësisë e BE-së, sipas së cilës përcaktimi i pushimit javor në ditën e diel, i kryer nga direktiva 104/93, duhej konsideruar si i paligjshëm. GJDBE,

gjerë i rezevohet si gjithmonë akordeve kolektive. Ky aspekt i fundit ka tërhequr kritikën e doktrinës dhe nevojshmërinë e ndërhyrjes së Gjykatës Kushtetuese²², e cila është shprehur për legjitimitetin e parashikimeve që bëjnë të mundur përfitimin e pushimit javor përtej periudhave 7 ditore, me kushtin e përdorimit të këtyre mundësive ligjore vetëm në rastet e nevojave të qarta që mbrojnë interesa madhorë dhe me ruajtjen e periudhës së pushimit në formën e mesatares në harkun kohor referues prej 2 javësh²³.

Në lidhje në pushimet vjetore neni 10 i dekretit parashikon të drejtën e punëmarrësve për një periudhë pushimi jo më të shkurtër se 4 javë, duke vendosur në këtë mënyrë një limit kohor sasior minimal dhe duke tejkuluar përcaktimet e mëparshme të kryera nga ligji n. 157/1981 i cili, duke ratifikuar Konventën ILO n. 132/1970, fliste për një periudhë minimale prej 3 javësh pushimesh vjetore. Parashikimi aktual, duke ju referuar nenit 2109 të Kodit civil italian, rimerr nevojën e përfitimit të një pjese të pushimeve vjetore në mënyrë të vazhdueshme me qëllim realizimin e ripërtëritjes së energjiave psiko-fizike dhe të nevojave personale, private dhe familjare të punëmarrësit. Periudha e përfitimit caktohet nga punëdhënësi duke mbajtur parasysh organizimin e aktivitetit të punës dhe interesat e punëmarrësit, i komunikohet këtij të fundit sa më herët të jetë e mundur, dhe përfitohet në mënyrë të vazhdueshme për të paktën dy javë brenda vitit në të cilin pushimet janë mbledhur dhe për pjesën e mbetur brenda 18 muajve pasues të kësaj periudhe, përveç parashikimeve të ndryshme të kryera nga akordet kolektive.

Rëndësi të veçantë ka parashikimi i përmbajtur në pikën 2 të nenit 10, sipas së cilit periudha minimale prej 4 javësh nuk mund të zëvendësohet nga dëmshpërblim për mospërfitim të pushimeve vjetore, përveç rasteve të zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si dhe janë të pavlefshëm të gjitha akordet mes paleve për heqjen dorë nga pushimet vjetore. Në këtë mënyrë kemi riafirmimin e parimit kushtetues (neni 36, pika 3) sipas së cilit punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga pushimet vjetore të paguara.

Në lidhje me pushimet vjetore që nuk janë përfituar brenda periudhës maksimale prej 18 muajsh pas mbledhjes së tyre, duke patur parasysh parimin që ndalon monetizimin e pushimeve të papërfituara, duhet thënë se punëmarrësi nuk e humbet të drejtën e përfitimit të tyre edhe përtej periudhës maksimale, ndërkohë që një monetizim i tyre është i mundur vetëm nëse kemi përfundimin e raportit të punës. Humbja definitive e mundësisë së përfitimit të pushimeve vjetore, sikurse specifikon Gjykata e Bashkimit Europian (C-619/16, C-684/16), mund të realizohet në ato raste kur punëmarrësi nuk

12.11.1996, (C- 84/94), *Foro it.*, 1997, III, kk. 280-304.

22 GJK, n. 101/1975, *Riv. Giur. lav.*, 1975, II, ff. 335-342. GJK, n. 146/1971, *Foro. It.*, 1971, I.2, kk. 2140-2142.

23 TIRABOSCHI M., RUSSO A., *cit.* f. 23. LECCESE V., *cit.* f. 70.

ushtron të drejtën e tij në mënyrë të vullnetshme dhe të vetëdijshme edhe pse i është garantuar mundësia e përfitimit nga ana e punëdhënësit. Në këtë mënyrë, punëmarrësi që nuk e ka ushtruar të drejtën e tij për pushime vjetore, humbet me përfundimin e marrëdhënies së punës mundësinë e monetizimit të pushimeve të paperfituara. Sidoqoftë, po sipas GJDBE, për humbjen e kësaj të drejte nuk mjafton fakti i mos kërimit të pushimeve vjetore nga ana e punëmarrësit, por duhet të kemi një refuzim të vullnetshëm dhe të vetëdijshëm nga ana e tij edhe pas ftesës së drejtuar nga punëdhënësi për t'i përfituar ato.

5. Puna e kryer gjatë orëve të natës.

Legjislatori italian përgjatë veprimtarisë së përshtatjes kundrejt kërkesave të direktivës n. 93/104 kishte rregulluar paraprakisht disiplinën e punës së kryer gjatë orëve të natës nëpërmjet dekretit legjislativ n. 532/1999, e cila është rishikuar tërësisht nëpërmjet dekretit n. 66/2003, që sjell një sërë risish përsa i përket kushteve dhe rregullave që duhen ndjekur për ushtrimin e aktivitetit të punës gjatë këtij orari.

Neni 11 i dekretit n. 66/2013 së pari përmban detyrimin e vlerësimit të aftësisë mjekësore për të kryer aktivitet pune gjatë orëve të natës, nëpërmjet strukturave shëndetësore publike kompetente duke ja hequr tanimë këtë mundësi mjekut të familjes dhe së dyti parashikon detyrimin për të gjithë punëmarrësit për të kryer aktivitet pune gjatë orëve të natës. Ky i fundit mbetet sidoqoftë një detyrim jo absolut duke qenë se normativa parashikon disa momente përjashtuese që iu referohen grave shtatzëna dhe grave me fëmijë deri në moshën 1 vjeç, të cilat nuk kanë detyrimin e punësimit nga mesnata deri në orën 6 të mëngjesit. E njëjta mundësi, nëpërmjet akordeve individuale, iu ofrohen gjithashtu edhe prindërve me fëmijë deri në moshën 3 vjeç, prindi i vetëm me fëmijë deri në moshën 12 vjeç, punëmarrësit që kanë në ngarkim një person me aftësi të kufizuara²⁴. Gjithashtu akordet kolektive mund të përcaktojnë kategori dhe raste të tjera për të cilat mund të përjashtohet punësimi gjatë orëve të natës.

Përsa i përket aspekteve procedurale që duhen ndjekur në përdorimin e punës së natës, neni 12 specifikon se duhen respektuar dy detyrime të veçanta që lidhen me këshillimin paraprak të përfaqësive sindikale të ndërmarrjes (të cilat duhet të jenë pjesë e organizatave përfaqësuese që kanë nënshkruar akordet kolektive) ose organizatave territoriale kompetente të punëmarrësve dhe me komunikimin nga ana e punëdhënësit, për çdo periudhë 12 mujore,

²⁴ Normativa parashikon, si në rastin e ndalimit absolut edhe në rastin e akordeve individuale deroguese, masa ndëshkuese për punëdhënësit që vendos në punë gjatë orëve të natës punëmarrësit e kategorive të cituara. Në këto raste masat mund të shkojnë në arrest me burg nga 2 deri në 4 muaj ose me gjobë nga 516 euro deri në 2582 euro.

te organet përkatëse të inspektimit të punës së natës së kryer në mënyrë të vazhdueshme ose nëpërmjet turneve periodike, përveç atyre rasteve kur kjo mundësi është parashikuar nga akordet kolektive.

Natyre thelbesore kanë gjithashtu parashikimet e përmbajtura në nenin 13 të dekretit, përcaktuese të kohëzgjatjes së orarit ditor të punës për punëmarrësit e natës, kohëzgjatje e cila nuk duhet të kalojë mesatarisht 8 orët në 24 orësh, mesatare kjo që mund të derogohet nga akordet kolektive apo në nivel ndërmarrjeje²⁵. Akordeve kolektive iu delegohet gjithashtu mundësia për të parashikuar një kohëzgjatje më të ulët të orarit të punës për punëmarrësit që kryejnë aktivitetin e tyre, ose një pjesë të tij, gjate orëve të natës si edhe përcaktimin e trajtimit ekonomik që këta punëmarrës përfitojnë.

Tjetër aspekt i rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësit është detyrimi i kontrollit të integritetit fizik të tij në mënyrë preventive dhe periodike me qëllim vlerësimin e mungesës së shkaqeve që bëjnë të pamundur zhvillimin e punës së natës dhe detyrimi për punëdhënësin që të garantojë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse individuale dhe kolektive në mënyrë që të shmangen sa më shumë rreziqet derivuese nga puna gjatë orëve të natës. Në mbyllje mund të shtohet se qëllimi i mbrojtjes së shëndetit del në pah edhe në nenin 15 i cili i jep mundësinë punëmarrësit me gjendje shëndetësore të papërshtatshme për punën e natës të transferohet në aktivitete pune të kryera gjatë ditës dhe detyra ekuivalente me ato që ai ka patur më herët, nëse ekzistojnë në ndërmarrje gjatë harkut kohor të ri.

Bibliografia

- DEL PUNTA R., *La riforma dell'orario di lavoro, Dir. Prat. Lav.*, 2003, n. 22.
FERRANTE V., *La nuova legge tema di lavoro straordinario, Nuove leggi civ. comm.*, 1999, ff. 799-820. FERRANTE V., *La disciplina del lavoro notturno, Nuove leggi civ. comm.*, 2000, ff. 534-555.
FERRANTE V., *Nuova disciplina dell'orario di lavoro, "Il 'pacchetto Treu'"*,
NAPOLI M., *Nuove leggi civ. comm.*, 1998, ff. 1305-1325.
FRANCI R., *L'orario di lavoro e le modalità della prestazione, Lav. prev. oggi*, 2003.
GJDBE, 12.11.1996, (C- 84/94), *Foro it.*, 1997, III, kk. 280-304.
GJK, n. 101/1975, *Riv. Giur. lav.*, 1975, II, ff. 335-342.
GJK, n. 146/1971, *Foro. It.*, 1971, I.2, kk. 2140-2142.
GJL 1.9.1997, n. 8267, *Mass. Giur. Lav.*, 1997, ff. 818-826;
GJL 5.2.2000, n. 1307, *Dir. rel. ind.*, 2000, ff. 389-393.
LAI M., *Nuova disciplina del tempo di lavoro e tutela della salute e della sicurezza: riflessioni sul d. lgs., n. 66/2003, Riv. It. Dir. Lav.*, 2004, I.

²⁵ LECCESE V., *cit. f. 79.*

LECCESE V., *L'orario di lavoro tra ordinamento interno e disciplina comunitaria*, *Nuove leggi civ. comm.*, 2004, II.

LECCESE V., *L'orario di lavoro. La normativa italiana di attuazione delle direttive comunitarie*, IPSOA, 2004.

LECCESE V., *La disciplina dell'orario di lavoro nel d. lgs. n. 66/2003, come modificato dal d. lgs. n. 213/2004*, www.lex.unict.it.

RICCI G., *Orario di lavoro: la condanna della Corte di Giustizia Ue*, *Guida lav.*, 2000, n. 17.

TIRABOSCHI M., RUSSO A., *Prime osservazioni sull'attuazione della direttiva n. 93/104/Ce*, *Guida lav.*, 2003, n. 17.

Nacionalizmi banal dhe turizmi. Rasti i Shqipërisë dhe Kosovës

Kriton Kuci PhD
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
kritonkuci@umsh.edu.al

Abstrakt

Ky studim analizon marrëdhënien midis nacionalizmit banal dhe turizmit në Shqipëri dhe Kosovë. Qëllimi është të vihen në dukje mënyrat nëpërmjet të cilave komponentët e përditshëm të nacionalizmit bëhen pjesë e praktikave, politikave dhe përfaqësimeve në sektorin e turizmit. Duke u mbështetur në qasjen e nacionalizmit banal të Michael Billig, studimi analizon dimensionet materiale, ideologjike dhe diskursive të ndërtimit të identitetit kombëtar në fushën e turizmit. Faqet zyrtare të agjencive kombëtare të turizmit të Shqipërisë dhe Kosovës analizohen me qëllim detektimin e mënyrave nëpërmjet të cilave diskurset nacionaliste, narrativat historike dhe simbolet kulturore përdoren për të formësuar dhe përforcuar identitetin kombëtar. Në rastin e Shqipërisë komponentët e nacionalizmit banal (siç janë narrativat historike të përzgjedhura në mënyrë selektive) shfaqen në mënyrë më diskrete. Ndërkohë, rasti i Kosovës paraqet një diskurs më të hapur nacionalist, duke përdorur tema primordialiste dhe një kornizë “ne” kundër “atyre”, veçanërisht në portretizimin e periudhave osmane, jugosllave dhe serbe. Ky punim kontribuon për të kuptuar se si turizmi shërben si një platformë për riprodhimin e ideologjive nacionaliste dhe formësimin e identiteteve kolektive në Evropën Juglindore.

Fjalët kyçe: nacionalizëm banal, nacionalizëm i përditshëm, turizëm , faqe zyrtare të turizmit, Shqipëri, Kosovë

Abstract

This study explores the relation between banal nationalism and tourism in Albania and Kosovo. It aims to detect the ways in which everyday markers of nationalism are incorporated within tourism practices, policies, and representations. Drawing on Michael Billig’s approach of banal nationalism, the research examines the material, ideological, and discursive dimensions of national identity construction in tourism. Official tourism websites are analyzed in order to reveal how nationalist discourses, historical narratives, and cultural symbols are mobilized in order to shape and reinforce national identity.

The Albanian case highlights quite subtle banal nationalist tropes, such as

selective historical narratives emphasizing ancient origins and continuous national struggles. Meanwhile, the Kosovo case presents a more opened nationalist discourse, employing primordialist themes and an “us-versus-them” framework, particularly in its portrayal of Ottoman, Yugoslav and Serbian rule. Both contexts underscore the dual function of tourism as a tool for national pride and soft power diplomacy while exposing the risks of exclusionary narratives. This analysis contributes to understanding how tourism serves as a platform for the reproduction of nationalist ideologies and the shaping of collective identities in Southeast Europe.

Key words: banal nationalism, everyday nationalism, tourism, official tourism websites, Albania, Kosovo

Nacionalizmi banal dhe turizmi

Nacionalizmi banal, një koncept i themeluar nga Michael Billig, i referohet mënyrave diskrete dhe shpesh të pa vëna re nëpërmjet të cilave ideologjia nacionaliste përshkon jetën e përditshme, duke formësuar perceptimet e individëve në lidhje me kombin dhe kombësinë por pa shfaqur (në dukje) një retorikë (të hapur) nacionaliste (Billig, 1995). Në shoqëritë e sotme, ekziston një proces i vazhdueshëm, i përditshëm i rikujtimit të kombësisë dhe ky proces është arsyeja pse “ne”, anëtarët e kombeve, nuk e harrojmë identitetin tonë kombëtar. Nacionalizmi banal përshkruan pikërisht procesin nëpërmjet të cilit subjektet kombëtare rikujtohen në përditshmërinë e tyre për faktin se janë anëtarë të një kombi të caktuar dhe se bota në të cilën jetojnë është një botë e ndërtuar nga kombet dhe e ndarë ndërmjet kombeve. Për qasjen e nacionalizmit banal, koncepti i nacionalizmit zgjerohet deri në atë pikë sa të përfshijë mjetet dhe zakonet ideologjike që bëjnë të mundur riprodhimin e kombit. E thënë më fjalë të tjera nacionalist nuk konsiderohet vetëm ai i cili është i gatshëm të luftojë më armë për kombin e tij por edhe ai i cili e merr të mirëqënë egzistencën e kombit si dicka të dhënë dhe natyrale dhe në këtë mënyrë ndërton dhe riprodhon diskurse në lidhje me kombin. (Kuci, 2022) Këto diskurse ndërtohen në një hapësirë sociale brenda së cilës rikujtesa e përditshme e kombit dhe kombësisë është shndërruar në një komponent thelbësor të saj. Dhe është pikërisht kjo arsyeja se pse “ne” nuk e harrojmë identitetin tonë kombëtar. Sipas Michael Billig, në shoqëritë e sotme kombësia rikujtohet vazhdimisht përmes praktikave sociale dhe zakoneve ideologjike dhe diskursive (Billig, 1995). Turizmi, si një praktikë sociale por edhe si një industri që funksionon brenda kornizave të imponuara nga sistemi kapitalist gjithashtu bën pjesën e tij për të riprodhuar idenë e kombit dhe të kombësisë duke i rikujtuar cdokujt kush jemi “ne” por edhe kush janë “ata”.

Shfaqjet materiale të nacionalizmit banal në turizëm mund të detektohen në aspekte të ndryshme të destinacioneve si dhe të përvojave turistike. Infrastruktura turistike por edhe politikat e turizmit shpesh herë pasqyrojnë axhendat nacionaliste. Qeveritë dhe autoritetet lokale investojnë shumë më lehtë në projekte që promovojnë arritjet kombëtare, trashëgiminë dhe veçoritë kulturore, pra në projekte të cilat mund të justifikohen më thjeshtë nëq përmbajnë elemente kombëtare (Edensor, 2002; Hall, 2007; Polese, Amrosio, Kerikmae 2020). Le të rikujtojmë këtu projektin e sheshit Skënderbej dhe “faktin” se pllakat e përdorura për ndërtimin e tij vinin nga “të gjitha trojet shqiptare, përfshirë këtu edhe nga Kosova dhe zona të tjera ku jetojnë shqiptarë” (<https://www.balkanweb.com/projekti-ja-si-do-te-jete-sheshi-skenderbej-realizohet-per-12-muaj/#gsc.tab=0>). Ndërtimi i monumenteve, muzeve dhe vendeve të trashëgimisë shërben për të simbolizuar dhe përforcuar identitetin kombëtar, duke ftuar turistët të marrin pjesë në glorifikimin kolektiv të kombit (Naef, P.J. 2017; Smith, 2009; Winter, 2012; Hassan & Miran, 2015). Për më tepër, komodifikimi i simboleve dhe imazheve kombëtare në marketingun e turizmit përforcon më tej diskursin nacionalist (Hall & Page, 2019; Edensor, 2002). Broshurat turistike, reklamat dhe fushatat promovuese shpesh mbështeten në përfaqësimet stereotipike të identitetit kombëtar për të tërhequr vizitorë, duke përjetësuar narrativa të thjeshtuara dhe të esencializuara të vendit pritës (White, 2017). Ky komodifikim i identitetit kombëtar jo vetëm që formon perceptimet e turistëve, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin dhe përhapjen e ideologjisë nacionaliste brenda dhe përtej destinacioneve turistike (Smith, 2009; Winter, 2012).

Përveç manifestimeve materiale, nacionalizmi banal në turizëm vepron përmes mekanizmave ideologjike që përforcojnë supozimet e marra si të mirëqena për kombin. Narrativat, përfaqësimet dhe shfaqjet turistike luajnë një rol vendimtar në ndërtimin dhe përjetësimin e ideologjive nacionaliste, duke vendosur përvojën e vizitorit brenda kontekstit të historisë, identitetit dhe vlerave kombëtare (Dann, 1996; Edensor, 2002; Storm 2014). Vendet e trashëgimisë kulturore, muzetë dhe vizitat me guidë shpesh shërbejnë si mjete për përhapjen e narrativave nacionaliste, duke promovuar një ndjenjë të përkatësisë kolektive dhe identitetit të përbashkët midis turistëve (Macdonald, 2013; Smith, 2009). Politikat dhe praktikat turistike shpesh janë të mbushura me axhenda nacionaliste nga autoritetet zyrtare të turizmit të cilat përdorin turizmin si një mjet për riprodhimin e kombit por edhe si një mjet të diplomacisë kulturore dhe projeksionit të fuqisë së butë (Hall & Page, 2019; Winter, 2012). Strategji të tilla si festivalet kulturore dhe iniciativat për ruajtjen e trashëgimisë përdoren për të rritur imazhin dhe reputacionin e

kombit në skenën globale, duke nxitur ndjenjën e krenarisë dhe identitetit kombëtar midis turistëve (Hassan & Miran, 2015; Anholt, 2021).

Nacionalizmi banal vepron edhe nëpërmjet formacioneve diskursive që formësojnë prodhimin dhe konsumimin e identitetit kombëtar në kontekstet turistike. Narrativat turistike, guidat dhe materialet promovuese shpesh përdorin strategji diskursive që natyralizojnë dhe përforcojnë ideologjitë nacionaliste, duke inkuadruar përvojën turistike brenda narrativave dhe simboleve të veçanta kombëtare (Edensor, 2002; Dann, 1996; Winter, 2012). Këto konstrukte diskursive jo vetëm që formojnë perceptimet e turistëve, por gjithashtu kontribuojnë në riprodhimin dhe normalizimin e komponentëve dhe stereotipeve banale nacionaliste brenda diskursit turistik (White, 2017).

Në praktikatat e përditshme të turizmit, individët angazhohen në mënyrë aktive në ndërtimin dhe negocimin e identiteteve kombëtare përmes ndërveprimeve të tyre me komunitetet lokale, artefaktet kulturore dhe peizazhet (Edensor, 2002; Winter, 2012). Turistët interpretojnë dhe ja atribuojnë kuptimin përvojave të tyre të udhëtimit bazuar në nocionet e tyre të paramenduara të identitetit kombëtar, shpesh duke u mbështetur në diskurse dhe përfaqësime nacionaliste (Hassan & Miran, 2015). Blerja e suvenireve, për shembull, bëhet një mënyrë për turistët për të mbledhur dhe shfaqur simbole të identitetit kombëtar, duke përforcuar ndjenjën e tyre të përkatësisë ndaj një kombi të caktuar (Edensor, 2002; Dann, 1996).

Për më tepër, konsumi i ushqimit, muzikës dhe produkteve të tjera kulturore në mjediset turistike bëhet i mbushur me kuptime nacionaliste, pasi turistët kërkojnë përvoja autentike që përputhen me perceptimet e tyre të imagjinuara për kombin pritës (Bessière & Tibere, 2013; Winter, 2012). Duke u angazhuar në këto praktika të përditshme, turistët marrin pjesë aktive në riprodhimin dhe përhapjen e diskurseve nacionaliste, duke kontribuar në përjetësimin e narrativave të identitetit kombëtar në kontekstet turistike (Edensor, 2002).

Marrëdhënia midis nacionalizmit banal dhe turizmit përfshin dimensionet materiale, ideologjike dhe diskursive, si dhe praktikatat e përditshme përmes të cilave nacionalizmi zbatohet dhe kontestohet në mjediset turistike. Duke shqyrtuar këto dimensione, ky rishikim i zgjeruar i literaturës ofron njohuri të vlefshme për ndërveprimin kompleks midis nacionalizmit banal dhe turizmit, duke theksuar mënyrat në të cilat ideologjitë dhe identitetet nacionaliste ndërtohen, kryhen dhe konsumohen brenda kontekstit të turizmit. Kuptimi i këtyre dinamikave është thelbësor për të analizuar në mënyrë kritike rolin e turizmit në formësimin dhe përjetësimin e diskurseve dhe identiteteve nacionaliste në shoqëritë bashkëkohore.

Manifestimet e nacionalizmit banal në turizëm

Uebsajtet zyrtare të turizmit shërbejnë si porta dixhitale, duke u ofruar qytetarëve vendas dhe audiencës ndërkombëtare një përmbledhje të shkurtër të identitetit, atraksioneve dhe trashëgimisë kulturore të një kombi. Përtej funksionit të tyre parësor të promovimit të turizmit, këto platforma luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin dhe përforcimin e narrativave nacionaliste. Nëpërmjet përmbajtjes së ndërtuar me kujdes që përfshin narrativa, imazhe dhe rrëfime historike, faqet e internetit zyrtare të turizmit krijojnë një imazh specifik të kombit, duke promovuar monumentet, festivalet kulturore dhe arritjet historike për të rrënjësuar një ndjenjë krenarie dhe uniteti mes qytetarëve duke projektuar një version të idealizuar të kombi ndaj botës; (Malenkina & Ivanov, 2018, Houliston, Ivanov, Webster, 2021; Hallett, 2011; Lee & Gretzel, 2011) Trashëgimia kulturore, thelbësore për axhendat nacionaliste, shfaqet dukshëm në këto platforma, me traditat, kulinarinë dhe zakonet e konsideruara si përbërës thelbësorë të identitetit kombëtar (Smith, 2009; Polese, Ambrosio, Kerikmae 2020; Hassan & Miran, 2015). Për më tepër, faqet zyrtare të turizmit në internet shërbejnë si instrumente të diplomacisë së fuqisë së butë, duke projektuar një imazh pozitiv tek komuniteti ndërkombëtar për të ndikuar në perceptimet globale dhe për të përimësuar pozicionin e vendit në arenën ndërkombëtare (Anholt, 2021; Hall & Page, 2019; Winter, 2012). Megjithatë, ndërtimi dhe riprodhimi i identitetit kombëtar në këto platforma nuk ka se si të mos përmbajë problematikat që përmban ky proces edhe në hapësira të tjera sociale dhe politike. Paraqitja selektive dhe mosveprimi i disa aspekteve historike ose kulturore mund të përjetësojë stereotipet, të margjinalizojë komunitetet dhe të përforcojë format përjashtuese të nacionalizmit (Houliston, Ivanov, & Webster, 2021; Macdonald, 2013). Pavarësisht nga këto kompleksitete, faqet e internetit zyrtare të turizmit mbeten me ndikim në formësimin e perceptimeve të identitetit kombëtar, duke e bërë të domosdoshme vlerësimin kritik të implikimeve të narrativave të tyre për dinamikat më të gjera socio-politike. Promovimi i turizmit përmes faqeve zyrtare të turizmit kombëtar, mishëron elemente të nacionalizmit banal, procesi ku simbolet kombëtare, diskurset dhe narrativat janë aq thellë të ngulitura në jetën e përditshme sa që ato bëhen pothuajse të padukshme, por vazhdimisht përforcojnë ndjenjën e identitetit kombëtar (Billig, 1995; Edensor, 2002 Hall & Page, 2019)

Shqipëria

Karakteristika e parë që bie në sy në faqen e Agjencisë Kombëtare Shqiptare të Turizmit (<https://akt.gov.al/>) është mungesa e flamurit dhe simboleve kombëtare, të cilat, sipas traditës së nacionalizmit banal, janë komponentë

qendrorë. Vetë Michael Billig e identifikon flamurin kombëtar, veçanërisht kur ai varet pa u vënë re jashtë ndërtesave publike, si një imazh metonimik thelbësor të nacionalizmit banal (Billig, 1995). Në këtë faqe interneti, flamuri shfaqet vetëm në seksionin e përzgjedhjes së gjuhës. Megjithatë, mungesa e tij nga faqja nuk tregon mungesë të nacionalizmit banal. Përkundrazi, prania e tij është e nënkuptuar dhe e përhapur.

Ndërsa simbolet materiale si flamujt ose emblemat e tjera kombëtare janë rikujtues të rëndësishëm të identitetit kombëtar (flaggings sic i emërton Billig) ato nuk janë komponentët e vetëm të nacionalizmit banal. Aspekti vërtet banal – ose i zakonshëm – qëndron në supozimet e marra si të mirëqena në lidhje me kombin: në lidhje me atë çfarë është kombi dhe identiteti kombëtar, atdheu, gjuha territori etj. Këto elemente banale përfshijnë pohime të zakonshme për historinë e kombit, lashtësinë e tij, të ashtuquajturën autoktoni dhe vazhdimësinë e supozuar të tij. Është pikërisht ajo që rëndom konsiderojmë si logjikë të thjeshtë në lidhje me kombin dhe cdo gjë që lidhet me të, që është edhe elementi me thelbësor i nacionalizmit banal. (Kuci, 2022) Ajo çfarë rëndom konsiderohet si dicka që “edhe një fëmijë në kopësht duhet ta dijë” në lidhje me kombin dhe cdo gjë që lidhet me të, që është edhe thelbi i nacionalizmit banal. Logjikën e thjeshtë nuk e vendosim asnjëherë në dyshim, e marrim si të mirëqenë. E megjithatë kur vjen çështja te kombi dhe cdo gjë që lidhet me të është pikërisht kjo logjikë e thjeshtë që duhet vendosur në dyshim. Sepse nacionalizmi ka ndërtuar logjikën e thjeshtë të modernitetit (Billig, 1995).

Për më tepër, në rastin konkret, nacionalizmi banal manifestohet kryesisht nëpërmjet qasjes selektive të përdorur nga historiografia kombëtare zyrtare.

Kur shqyrton rubrikën Historia e Shqipërisë në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, del në pah nacionalizmi banal që përshkon të gjithë përmbajtjen e kësaj faqeje. Teksti fillon me një frazë gati paradoksale: “Gjeneza e çdo kombi është historia e tij.” Përdor fjalën paradoksale sepse në pamje të parë, kjo shprehje mund të duket si një citim nga Eric Hobsbawm, i cili analizon në mënyrë kritike rolin që luan historiografia në ndërtimin e kombit duke qëndruar larg nacionalizmit metodologjik si pak historianë të tjerë. Megjithatë, duke marrë parasysh kontekstin, kjo frazë funksionon krejt ndryshe nga ajo që mund të nënkuptonte Hobsbawm.

Narrativa historike e paraqitur përputhet ngushtë me narrativën zyrtare kombëtare shqiptare. Historia portretizohet si një varg betejash të pandërprera të zhvilluara nga kombi shqiptar. Kjo narrativë thjeshtëzon të kaluarën komplekse të Shqipërisë. Historia e cdo vendi është komplekse por është historiografia zyrtare ajo që e thjeshtëzon atë duke vendosur theksin te disa periudha e duke lënë periudha të tjera në harresë. Historia e kombeve

është njëkohësisht edhe amnezia e tyre. Në rastin konkret narrativaa historike e paraqitur vendos theksin te temat e zakonshme të historiografisë nacionaliste: rrënjët e lashta të kombit, luftërat e tij për pavarësi dhe rëndësinë e tij gjeopolitike. Një qasje e tillë reduktuese dhe thjeshtëzuese pasqyron tendencat e diskursit nacionalist, nga njëra anë duke paraqitur një progresion të idealizuar, linear të historisë kombëtare dhe nga ana tjetër duke lënë pas dore nuancat dhe interpretimet e kontestuara të saj.

Teksti paraqet historinë e Shqipërisë si një përpjekje e vazhdueshme për pavarësi dhe vetëvendosje. Si një histori lineare betejash epike kundër pushtuesve të huaj si Perandoria Osmane. Periudha historike si Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe shpallja e pavarësisë në 1912, paraqiten si momente përcaktuese që formësuan trajektoren e kombit, si qëllime finale të historisë shekullore të kombit shqiptar. Në qendër të rrëfimit janë heronjtë kombëtarë si Skënderbeu, të cilët mishërojnë frymën e rezistencës dhe atdhedashurisë. Teksti vlerëson gjithashtu përpjekjet e Shqipërisë për modernizimin dhe integrimin në komunitetin global, veçanërisht nëpërmjet anëtarësimit në NATO dhe aspiratave për integrimin në Bashkimin Evropian, duke i paraqitur këto si arritje kombëtare.

The adoption by the United Nations General Assembly of Resolution 66/290, on September 10, 2012, was another important step for the implementation of human security. In paragraph 3 of the Resolution, the General Assembly recognized by consensus that human security is an effort to assist member states in identifying and addressing pervasive changes and challenges to the survival, well-being and dignity of their people (Human Security Handbook, 2016, p. 45).

Non-governmental organizations such as the International Committee of the Red Cross, Medecins Sans Frontieres, Save the Children, and Amnesty International have also contributed in different ways to human security issues. They have served as sources of information and warning of conflicts. They have provided opportunities for rescue operations, often being the first in action in areas of conflict or natural disasters and supporting governments or United Nations-sponsored peacekeeping and peacebuilding missions.

Conclusions

Now the traditional security threats have faded and therefore most people no longer consider them as urgent. People face new threats in their lives, which have made it necessary to expand the concept of security. The concept of human security has developed through the debate whether states or the individual should have more priority.

Although, security in the traditional sense is necessary for the life and well-being of the individual, now individuals, societies and states, in the concept of security, do not only value territorial integrity, but also other factors, thus promoting social-economic security (Thakur, 2010 , p.11). However, it must be recognized that human security is connected and interdependent with state security.

State security is no longer a sufficient source of security because it does not adequately respond to the security of the individual from violence within states. The traditional concept of state security, focusing on the territorial security of the state, fails to analyze many other risk factors, caused by other insecurities such as poverty, environmental hazards, global epidemic diseases, natural disasters, gender-based violence etc. Such threats often become invisible in the public debate that generally focuses on “major” concerns for the national security of the state, or for public safety, in relation to the fight against crime or violent conflicts, clearly exposed.

Human security is achieved when individuals have the right to identify risks and threats to their values and well-being and have the opportunity to find ways to end or alleviate these risks and threats (Hamourtziadou, 2019, p.121). Human security can be expanded by highlighting inequalities,

which are often the main causes of conflicts, by strengthening the governing structures of states, by fulfilling political, economic and legal initiatives.

Uncertainties must be fought all together, comprehensively. Acting on a single issue is not enough. Only in this way will people facing crises and extreme poverty feel safe in all aspects of their lives, have the opportunity to ensure their well-being and respect for their rights and dignity.

Governments have the primary responsibility to ensure the survival, well-being and dignity of their people. The role of the international community is to complement and provide the necessary protection to governments, based on their request, in order to strengthen their capacities to respond to emerging threats. Human security also requires cooperation between governments, regional and international organizations and civil society (Human Security Handbook, 2016, p.45). However, in addition to the collective responsibilities of national and international institutions, individual responsibilities are also important, which must be combined with collective responsibilities. As long as we talk about human security, we must accept that people must also be responsible for its realization. The transition from state security to human security must also be accompanied by the transfer of responsibilities for its realization from the state to the community within the state and to all citizens of the world.

The international community must find new ways to ensure the protection of people from the dangers of the age of globalization which have a more devastating impact on people's lives than the military threats of states (Acharya, 2000, p. 4). An important support in the practical implementation of the concept of human security can also be provided by the UN, which in its fundamental act of constitutional character, the UN Charter, contains norms that focus on people's well-being.

Human security is a concept that has the potential to develop more and more. Development is an important condition for human security, just as security is a necessary condition for human development. The more advanced society is, the more democratic a state is, the more focused the state and society in general will be on the safety of the individual.

References

- Brundtland Report, 1987, <https://www.are.admin.ch/are/en/home/media/publications/sustainable-development/brundtland-report.html>
- Acharya A., Human Security, March 2000, [:https://www.researchgate.net/publication/339956544](https://www.researchgate.net/publication/339956544)
- Axworthy Ll., "Human Security and Global Governance", Global Governance, vol7, 2001, pp19–23, <https://www.jstor.org/stable/i27800280>

Babu R., From National Security to Human Security, The Journal of International Issues, Vol. 20, No. 1 (Spring 2016), pp. 30-41, <https://www.jstor.org/stable/10.2307/48505260>

Commission on Human Security, New York, 2003, <http://hdr.undp.org/en/nhdr/support/thematic/humansecurity/>

Hamourtziadou L., Security challenges of the 21st century: new challenges and perspectives, *Journal of Global Faultlines*, 1 December 2019, <https://www.scienceopen.com/hosted-document?doi=10.13169/jglobfaul.6.2.0121>

Human Rights Council, 2005, In larger freedom: towards development, security and human rights for all: report of the Secretary-General: addendum: explanatory note / by the Secretary-General

Human Security Handbook- the United Nations, January 2016, <https://www.un.org>

Human Security Report 2005. War and Peace in the 21st Century, Human Security Centre, University of British Columbia, Canada, Oxford University Press, 2005, p. VIII.

Johns L., A Critical Evaluation of the Concept of Human Security, Jul 5 2014, <https://www.e-ir.info/2014/07/05/a-critical-evaluation-of-the-concept-of-human-security/>

Jolly R., Ray D., National Human Development Reports and the Human Security Framework: A review of Analysis and Experience, Published 2006, <https://www.semanticscholar.org/paper/National-Human-Development-Reports-and-the-Human-A-Jolly-Ray/d2ee5dc9fed7507396c20bf03f06019c5ca1ff0f>

Kaldor M., NATO and human security, NATO Defense College (2022), <https://www.jstor.org/stable/resrep39556>

Liddo M., The impact of Covid-19 on Human Security, May 2021, CeSI, <https://www.cesi-italia.org>

MacFarlane N., and Yuen Foong Khong, *Human Security and the UN: A Critical History*, muse.jhu.edu

Manchanda R., Women's Agency in Peace Building: Gender Relations in Post-Conflict Reconstruction, *Economic and Political Weekly* Vol. 40, No. 44/45 (Oct. 29 - Nov. 4, 2005), pp. 4737-4745, <https://www.jstor.org/stable/4417360>

Massari A., Human Security, 2020, <https://www.jstor.org/stable/10.1163/j.ctv2gjwnw.47>

Neil S., MacFarlane; Khong F., *Human security and the UN: a critical history*, Indiana University Press, [2006] ©2006, https://www.worldcat.org/title/human-security-and-the-un-a-critical-history/oclc/61178119&referer=brief_results

Obama B., Remarks at the Acceptance of the Noble Peace Prize, 10 December 2009, Oslo, Norway, www.whitehouse.gov/.../remarks-president-acceptance

Ogata S., Cels J., Human Security—Protecting and Empowering the People, *Global Governance* Vol. 9, No. 3 (July–Sept. 2003), <https://www.jstor.org/stable/27800482>

Paris R., Human Security Paradigm Shift or Hot Air, 2001, <https://www.jstor.org/stable/3092123>

Ramcharan B., *Human Rights and Human Security*, Martinus Nijhoff Publishers, p.15.

Report of the Secretary-General, 27 March 2000, unpan1.un.org/intradoc/groups/.../unpan000923.pdf

Rome Statute of the International Criminal Court, Article 1, January 2002, <file:///C:/Users/user/Downloads/RS-Eng.pdf>

Taylor O., “Human Security - Conflict, Critique and Consensus: Colloquium Remarks and a Proposal for a Threshold-Based Definition”, in *Security Dialogue*, Vol. 35, No. 3, International Peace Research Institute, Oslo, Norway, Sage Publications, 2004, pp. 373-387.

Thakur R., *United Nations Peace and Security Collective Security*, www.cambridge.org/0521855179

The 1994 Human Development Report, <http://hdr.undp.org>

The Universal Declaration of Human Rights, Article 28, www.un.org/en/documents/udhr/

Thomas F., Dixon H., On the Threshold: Environmental Changes as Causes of Acute Conflict, *International Security* Vol. 16, No. 2 (Fall, 1991), pp. 76-116 (41 pages), <https://www.jstor.org/stable/2539061>

Thomas N. & Tow W. T., ‘The Utility of Human Security’, space.library.uq.edu.au/view/UQ:62912

Tow W., Trood R., “Linkages between traditional Security and Human Security”, *Asian Emerging Regional Order: Reconciling Traditional and Human Security*, Tokyo: United Nations University Press, 2000, pp13–32, <https://www.google.com/search?client=firefox-b-d&q=William+T+Tow+and+Russell+Trood%2C+%E2%80%9CLinkages+between+traditional+Security+and+Human+Security%E2%80%9D+>

Walker R., Population Growth and its Implications for Global Security, *The American Journal of Economics and Sociology* Vol. 75, No. 4, Is Overpopulation a Problem? Multiple Perspectives on this Perennial Question (September, 2016), <https://www.jstor.org/stable/45129327>

Wiseman G., The Palme Commission: New thinking about security, *International Commissions and the Power of Ideas*, file:///C:/Users/user/Downloads/international_commissions_and_the_power_of_ideas_-_sample_chapter_0.pdf

Wolfers, A., 1952, “National Security” as an Ambiguous Symbol, www.princeton.edu/.

Shqipëria antifashiste në anën e duhur të historisë në luftën e dytë botërore

Prof. Dr. Paskal Milo
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
paskal.milo@umsh.edu.al

Në historinë e kombit shqiptar ka ngjarje të mëdha të cilat kanë mbetur pika reference për brezat që kanë ardhur më pas. Është fjala për ato ngjarje që kanë krijuar epokë, që kanë hapur rrugën e progresit, që kanë formësuar e forcuar identitetin kombëtar, që themeluan dhe organizuan shtetin kombëtar, që e mbajtën gjallë e luftuan për liri, vetëdije, pavarësi e sovranitet kombëtar edhe atëherë kur në trojet arbërore ra hija e rëndë e zaptuesve të ndryshëm.

Përgjatë historisë së tyre shqiptarët kanë qënë të suksesshëm në ato raste kur kanë ditur të bashkohen e të orientohen mirë në labirintet e saj. Nuk e kanë bërë gjithnjë ndaj edhe ajo i ka goditur apo edhe ka tentuar t'i ç'regjistrojë nga analet e saj. Por sa herë që e kanë bërë kanë vendosur gurë themeli në mbijetesën e tyre si popull e në krijimin e tyre si komb e si shtet. Por nëse do të shtrohej pyetja që ka të bëjë edhe me titullin e këtij referimi, se cilat mund të ishin kriteret për të gjykuar nëse shqiptarët përgjatë historisë së tyre janë orientuar mirë apo gabim, ky kumtim nuk e merr përsipër që të jap një përgjigje të plotë sepse nuk është as koha dhe as vëndi.

Por ka një kriter që mund të jetë në krye të të gjithë të tjerave: sa dhe si një ngjarje historike përputhet me atributet e ekzistencës së një populli e të një kombi, të ruajtjes së identitetit e të vetëqënies kombëtare, me rrugën e progresit dhe të aleancave strategjike? Ka një mendim thuajse unanim mbarë shqiptar që ngjarje të tilla të historisë tonë kombëtare kanë qënë epoka e Skënderbeut, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Pavarësia Kombëtare e vulosur nga Kuvendi i Vlorës, Kongresi i Lushnjës e Lufta e Vlorës. Dhe po të shtyheshim deri në ditët tona në këtë radhë ngjarjesh do të hynin edhe rënia e komunizmit dhe fitorja e demokracisë në Shqipëri, çlirimi i Kosovës dhe pavarësia e saj.

Çdo vend e çdo komb në përgjithësi në çdo përplasje ciklike historike, në një mënyrë ose një tjetër merr pjesë, reshtohet në njërën ose në tjetrën anë dhe ngarkohet me përgjegjësi për të mirë apo për të keq para historisë por edhe të ardhmes së tij. Lufta e Dytë Botërore (1939 – 1945) ka qënë përplasje më e madhe në historinë e njerëzimit mes forcave të regresit të përfaqësuar nga fashizmi i të gjitha ngjyrave me forcat e progresit të radhitura në aleancën e Kombeve të Bashkuara Antifashiste. Gati 80 vjet

pasi kjo Luftë ka përfunduar me rrjedhoja katastrofike njerëzore, ekonomike e sociale, bota sot ndodhet para një rreziku shumë herë më të madh, shumë herë më dimensional e deri në kufijtë e imagjinatës ekstreme.

Përkujtimi i përfundimit të Luftës së Dytë Botërore sot nuk është një akt simbolik në respekt të ngjarjes thjeshtë si histori, as edhe një shërbesë shpirtërore për të vrarët e saj dhe aq më tepër për fitimtarët e saj. Është një thirrje për vigjilencën e për të ndaluar sa nuk është vonë turravrapin drejt një lufte që do të ketë vetëm rrjedhoja apokaliptike për njerëzimin.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore Shqipëria u ndodh e pushtuar nga ushtritë e Boshtit fashist. Musolini nuk i la asaj as edhe një fije sovraniteti formal por e bashkoi atë nën skeptrin e perandorisë e të flamurit me sëpatën e Liktorit. Regjimi gjerman i pushtimit që u vendos në Shqipëri pas atij italian ishte shumë më i egër por për demagogji e për të mashtruar shqiptarët u njohu një status “pavarësie”, praktikë që në një formë apo në tjetër e kishte zbatuar edhe në vende të tjera. Regjimet e pushtimit, italian apo gjerman pavarësisht nga format e ushtrimit të tyre, në thelb ishin njësoj dhe po kështu edhe në objektivat e tyre. Nga pikëpamja strategjike atyre u interesonte që në Shqipëri të mos bëhej asnjë rezistencë kundër tyre. Në funksion të këtij synimi siç ndodhi edhe në vende të tjera europiane, pushtuesit mobilizuan në Shqipëri edhe qeveri shërbyese e pakica mbështetëse shqiptare.

Shumica e popullit shqiptar iu kundërvu pushtuesve. Historia e rezistencës së tij antifashiste ka një emër të përveçëm dhe vend të veçantë në historinë e rezistencës antifashiste europiane. Legjitimiteti i saj është i padiskutueshëm. Kur shtrohet çështja për t’i dhënë përgjigje pyetjes se në cilën anë të Luftës u reshtua Shqipëria duhet bërë një analizë jashtë kornizës tradicionale të reshtimit mes palëve siç ndodh zakonisht me aleancat e shpallura ose të krijuara në proces gjatë saj mes shteteve sovrane. Shqipëria ishte një shtet i pushtuar, nuk kishte sovranitet ndonëse ekzistonin disa institucione pseudolegjitime që në momente të caktuara miratonin ligje e merrnin vendime, si dhe mbreti Zog, i cili ndonëse formalisht mbante një farë legjitimiteti, nuk u njoh dhe nuk u pranua si insitucion sovran nga Fuqitë e Mëdha të Kombeve të Bashkuara Antifashiste.

Në mungesë të institucioneve sovrane vakumin do ta plotësonin ato forca politiko – ushtarake që do të diktonin në terrenin e luftimeve vullnetin e tyre dhe që do të siguronin një mbështetje sa më të gjerë mes shqiptarëve. Përrjashtuar qeveritë shërbyese të pushtuesve që nuk kishin lënë vend për zgjedhje, tri shtabe politiko – ushtarake potencialisht ishin në lojë për të ndikuar në orientimin e Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore: Lëvizja e Legalitetit, Balli Kombëtar dhe Fronti Nacional Çlirimtar. Por edhe ky ndikim i tyre do të kushtëzohej nga shkalla e organizimit të rezistencës e të luftës së

armatosur kundër pushtuesve si dhe nga aftësia e tyre për të siguruar ose jo mbështetjen e Kombeve të Bashkuara Antifashiste.

Para shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore qëndronin tre alternativa zgjedhjeje: të rrinin mënjanë saj, asnjë; e dyta të bashkoheshin me Boshtin fashist dhe e treta të bëheshin pjesë e Kombeve të Bashkuara Antifashiste.Gjithësecila prej këtyre alternativave nuk do të ishte një akt i thjeshtë apo një vendimarrje e institucioneve ekzekutive dhe legjislative por një sipërmarrje shumë e përgjegjshme kombëtare, e vështirë dhe në rrethana të jashtëzakonshme.

A mund të ishte asnjë Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore?

E drejta dhe praktika ndërkombëtare e kishin të kodifikuar statusin e asnjësisë.Në Luftën e Dytë Botërore ajo u respektua në minimum dhe atë e ruajtën ose nuk ua prekën shteteve të tilla si Zvicra, Suedia, Turqia apo ndonjë vendi tjetër i vogël. Shqipëria nuk kishtetribute historike të asnjëanësisë ndonëse lindi si shtet i pavarur dhe asnjëanës nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha të kohës. Asnjëanësia e saj mbi një vit më vonë u dhunua nga po të njëjtat Fuqi që ishin shpallur gardianë të saj. Pas Luftës së Parë Botërore e Konferencës së Paqes në Paris ku ajo u rrezikua të copëtohej, Fuqitë e Mëdha europiane ia dorëzuan në fakt Italisë mbrojtjen e sovranitetit të shtetit shqiptar. Ishte pikërisht ky vendim që i shtroi rrugën 7 prillit 1939. Asnjëanësia në kushtet e pushtimit ishte siç edhe rezultoi në kohën e pushtimit gjerman një status formal që askush nuk e njohu përveç pushtuesve.Ai ishte i pamundur të realizohej **për një mijë shkaqe dhe arsye, të brëndshme dhe të jashtme, historike, kulturore, sociale dhe ekonomike.**

Asnjëanësia shqiptare në Luftën e Dytë Botërore edhe po qe se do të ishte shprehje e një vullneti të gjithë pranuar mbarëshqiptar nuk do të kishte asnjë shans për të mbijetuar.Asaj i mungonte faktori kryesor i jashtëm, dakortësia e Fuqive të Mëdha që ishin në luftë mes tyre.

Alternativa e dytë e shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore ishte të bashkoheshin me Boshtin fashist, me Italinë e Musolinit, me Gjermaninë e Hitlerit dhe me Japoninë e largët aziatike të perandorit Hirohito. Formalisht, Shqipëria e pushtuar dhe e bashkuar me Italinë fashiste u bë pjesë e Boshtit, madje u shpalli luftë edhe Britanisë së Madhe, Francës, Shteteve të Bashkuara dhe gjithë atyre vendeve me të cilat Musolini u fut në konflikt. Zyrtarisht ligjet dhe vendimet që e implikonin direkt Shqipërinë me Boshtin fashist u anuluan në kohën e pushtimit gjerman për t'i dhënë sadopak besueshmëri formulës së tyre të “sovranitetit relativ” të Shqipërisë.Nëse këto ligje dhe vendime do të kishin qëndruar në fuqi deri në përfundim të Luftës ato do të përbënin korpusin juridik të aktakuzës për Shqipërinë si satelit i

Boshtit fashist në Konferencën e ardhshme të Paqes.

Pretendimet dhe kërkesat për ta vendosur Shqipërinë në këtë status ishin të njohura e të shpallura zyrtarisht nga qeveria e fqinjët jugor të saj për t'i hapur rrugën aneksimit të një pjese të saj. Projekte të tjera copëtimi apo staturë vartësie qarkullonin gjatë Luftës si variante të mundshme për zbatim pas saj.

Alternativa e tretë ishte aleanca me Kombet e Bashkuara Antifashiste. Rrënjët e saj ishin në Kartën e Atlantikut të gushtit 1941, në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara në Uashington në janar 1942, në Konferencën e Teheranit, nëntor – dhjetor 1943. Më vonë ajo u pasurua me vendime të tjera të rëndësishme nga tri Fuqitë e Mëdha të Kombeve të Bashkuara. Në platformën e në luftën e madhe kundër fuqive të Boshtit u bashkuan demokracitë perëndimore, Shtetet e Bashkuara e Britania e Madhe me Bashkimin Sovjetik, si dhe vende e popujt të tjerë, parti, rryma, individë me bindje të ndryshme politike e fetare. Në vendet europiane të pushtuara nga fashizmi, rezistencë e luftë të armatosur deri në çlirim nuk bënë vetëm komunistët, por edhe social demokratët, liberalët e konservatorët. Të gjitha këto forca në përfundim të Luftës kishin të drejtën morale të vendosnin për mënyrën e qeverisjes së vendeve të tyre. Në shumicën e këtyre vendeve, ku më lehtë e ku më me vështirësi, u rivendosën rendi e qeverisja demokratike.

Me vullnetin e shumicës së shqiptarëve që iu bashkuan rezistencës antifashiste dhe luftës së armatosur çlirimtare kundër pushtuesve të huaj, Shqipëria **de facto** u bë pjesë e Aleancës së Kombeve të Bashkuara Antifashiste. Kjo luftë u njoh zyrtarisht edhe nga qeveritë e Fuqive të Mëdha Antifashiste. Dokumenti më i rëndësishëm i tyre që u bë referencë vlerësuese deri në përfundim të Luftës ishin Deklaratat e dhjetorit 1942 të këtyre qeverive. Deklarata të tjera në vijim me po të njëjtën përmbajtje, ardhja e misionëve ushtarakë britanike, amerikane e sovjetike në Shqipëri pas prillit 1943, furnizimi me armë, paisje luftarake dhe mbështetje financiare britanike dhe amerikane kryesisht për formacionet partizane, kordinimi i veprimeve operative e mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇI me Komandën e Shtabit Aleat të Mesdheut, etj, mbetën dëshmi të pakontestueshme të kësaj Aleance. Pjesëmarrja e shumicës së shqiptarëve në krah të Kombeve të Bashkuara Antifashiste rezultoi një vendim strategjik i mënçur. **Për herë të parë në historinë e tyre si komb e për herë të dytë si popull pas epokës së Skënderbeut, shqiptarët u radhitën në anën e duhur të historisë, me Fuqitë që mbronin lirinë, identitetin, vetëvendosjen dhe progresin.**

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e kreu misionin e saj të çlirimit të Shqipërisë. Por jehona dhe ndikimi i kësaj Luftë nuk u mbyll në kufirin e vitit 1944. Pas Luftë ajo i dha Shqipërisë për herë të parë si **subjekt ndërkombëtar**

një mbështetje që nuk e kishte gjetur më parë. Pavarësia dhe integriteti territorial i Shqipërisë kishte mbetur në të kaluarën peng e projekteve coptuese të Fuqive të Mëdha dhe të vendeve fqinje. Pas çlirimit të Shqipërisë ndonëse u tentua të ripërsëriteshin pjesërisht skenarët e vjetër të coptimit, ishte pozita e qartë antifashiste dhe çlirimtare që morri shumica e popullit shqiptar në Luftë, ishte vepra e atyre dhjetra mijra partizanëve dhe e mijra e mijra dëshmorëve e viktimave që e ndalën ripërsëritjen e historive të hidhura të së shkuarës jo të largët.

Ishte pikërisht kjo Luftë çlirimtare në aleancë me Kombet e Bashkuara Antifashiste që i dha të drejtë Shqipërisë të ulej në Konferencën e Paqes në Paris në verën e vitit 1946 jo si viktimë dhe as fajtorë siç u ulën mjaft vende të tjera që kishin bashkëpunuar me fuqitë e boshtit fashist dhe që u penalizuan me të drejtë nga kjo Konferencë. Shqipëria më të drejtën e saj si kontributore në luftën kundër fashizmit u radhit midis fituesve të Luftës dhe vuri firmën e saj në Traktatin e Paqes me Italinë si Fuqi Shoqe. Ajo gjithashtu si vend antifashist u ftua dhe mori pjesë në Konferencën e Dëshmperblimeve të Luftës me Gjermaninë në dhjetor 1945 - prill 1946, nënshkroi aktin përfundimtar të saj dhe u dëshmperblye me shuma modeste për dëmet që i ishin shkaktuar. Duke qënë në të drejtën e saj, Shqipërisë iu kthye ari monetar i grabitur nga pushtuesit gjermanë në vitin 1943.

Shqipëria antifashiste e Luftës së Dytë Botërore e vendosi popullin shqiptar mes fitimtarëve. Edhe pas 20 apo edhe 200 viteve që do të vijnë, kjo ngjarje do të jetë e gdhendur në kujtesën kombëtare dhe do të qëndrojë aty përjetësisht për të dëshmuar se edhe një popull sado i vogël kur di të orientohet e të udhëhiqet drejtë në vorbullën e historisë mer vendime epokale e të patjetërsueshme që i japin nder e lavdi në shekuj.

Bashkimi European dhe Kina: mes bashkëpunimit dhe konkurrencës

Redion Luli PhD
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
redion.luli@umsh.edu.al

Abstrakt

Artikulli në fjalë shqyrton situatën e re që është krijuar në marrëdhëniet midis Kinës dhe Bashkimit European (BE). Rritja e shpejtë e Kinës bëri që politikëbërësit e BE-së në 2019 të mos e konsideronin më Kinën një vend në zhvillim dhe të kërkonin që ajo të merrte më shumë përgjegjësi për ruajtjen e rendit ekzistues botëror. Shpallja e Kinës si një “rival sistemik” ishte një tregues i shqetësimit dhe ankthit në rritje midis elitave europiane. BE synon jo vetëm të kërkojë marrëdhënie ekonomike më të balancuara dhe të barabarta me Kinën, por edhe të mbrojë me vendosmëri interesat e veta. “Rivaliteti sistemik” mund të ketë një nëntekst pozitiv, nëse Perëndimi trajton problemet e veta me qëllim rikthimin e atraktivitetit të modelit liberal. Disa ekspertë janë të mendimit se do të jetë e mundur të formohet një model i ri ndërveprimi midis Kinës dhe Europës, bazuar në përshtatjen e ndërsjellë ndaj ndryshimeve që po ndodhin. Bashkimi i Kinës dhe Evropës kundër unilateralizmit dhe proteksionizmit mund të pengohet nga lëvizja e BE-së drejt përdorimit në shkallë të gjerë të masave proteksioniste kundër Kinës. Artikulli thekson nevojën e kombinimit të projekteve të vjetra dhe të reja rajonale të integritimit në mënyrë të tillë që të parandalohet zhvillimi më tej i marrëdhënieve të konkurrencës së motivuar ideologjikisht ndërmjet tyre. Aftësia për t’iu përgjigjur me interes planeve të reja për bashkëpunim rajonal po bëhet një avantazh për Kinën në sfondin e kujdesit dhe tutjes që BE shfaq ndaj Iniciativës “Një Brez, një Rrugë”. Mjedisi global gjithnjë e më i pasigurt – i shënuar nga pandemia COVID-19 dhe konfliktet pasuese në Ukrainë dhe Gaza – ndërlikon përpjekjet për të menaxhuar marrëdhëniet BE-Kinë bazuar vetëm në interesat ekonomike.

Fjalët kyçe: Bashkimi European, Kina, rivalitet sistemik, bashkëpunim, autonomi strategjike, proteksionizëm, “Një Brez, një Rrugë”.

Abstract

The article examines the new situation that has emerged in relations between China and the European Union (EU). China’s rapid rise prompted EU policymakers in 2019 to no longer consider China a developing country and to demand that it take more responsibility for maintaining the existing

world order. The declaration of China as a “systemic rival” was an indicator of growing concern and anxiety among European elites. The EU aims not only to seek more balanced and equal economic relations with China, but also to firmly defend its own interests. “Systemic rivalry” may have a positive subtext, if the West addresses its own problems with the aim of restoring the attractiveness of the liberal model. Some experts believe that it will be possible to form a new model of interaction between China and Europe, based on mutual adaptation to the changes taking place. The unification of China and Europe against unilateralism and protectionism may be hindered by the EU’s move towards the large-scale use of protectionist measures against China. The article emphasizes the need to combine old and new regional integration projects in such a way as to prevent the further development of ideologically motivated competitive relations between them. The ability to respond with interest to new plans for regional cooperation is becoming an advantage for China against the background of the caution and detachment that the EU shows towards the “One Belt, One Road” Initiative. The increasingly uncertain global environment – marked by the COVID-19 pandemic and the subsequent conflicts in Ukraine and Gaza – complicates efforts to manage EU-China relations based solely on economic interests.

Keywords: European Union, China, systemic rivalry, cooperation, strategic autonomy, protectionism, “One Belt, One Road”.

Megjithëse BE-ja e konsideron Kinën si “një konkurrençe ekonomike dhe një rivale sistematike”, ajo mbetet një partner ekonomik tërheqës dhe një burim investimesh. Megjithatë, kushtet e veçanta kulturore, politike, gjeografike dhe ekonomike të Kinës, së bashku me sipërfaqen e saj të madhe gjeografike, e pengojnë atë të jetë një model i kompletuar.

Ndërsa rëndësia dhe ndikimi i Kinës zgjerohet për Bashkimin Europian (BE), qasja e ekuilibruar dhe koherente e politikës së BE ndaj Kinës po bëhet gjithnjë e më sfiduese. Nga njëra anë, Kina është një partner thelbësor tregtar dhe ekonomik për BE-në; nga ana tjetër, ajo paraqet një sfidë të rëndësishme në lidhje me të drejtat e njeriut, normat liberale dhe vlerat demokratike. Gjatë dy dekadave të fundit, ne e kemi parë Kinën të transformohet nga një vend në zhvillim i varur nga fuqia punëtore e lirë për t’u industrializuar dhe për të përmbushur nevojat e popullsisë së saj të madhe, duke marrë frymëzim nga modelet e sipërmarrjes kapitaliste dhe duke adoptuar elementë të një ekonomie tregu nën udhëheqjen e shtetit, të fokusuar fillimisht në prodhimin e produkteve të konsumit të përballeshëm, duke imituar teknologjinë e perëndimore – në një lojtar global të aftë, për të krijuar teknologji të avancuara që sfidojnë sistemin ndërkombëtar me qendër në SHBA.

Përcaktimi nga ana e Bashkimit Europian e një autonomie të qartë strategjike në politikën e tij tregtare, së bashku me kapitujt e zhvillimit të qëndrueshëm në Marrëveshjet e tij të Tregtisë së Lirë dhe direktivat e reja si Direktiva mbi Qëndrueshmërinë e Korporatave Due Diligence, rrit pritshmëritë normative për partnerët e tij tregtarë për çështje të tilla si klima, qëndrueshmëria, standardet e punës dhe të drejtat e punëmarësve. Vendeve dhe kompanive që tregtojnë me BE-në u kërkohet gjithnjë e më shumë të përputhen me këto norma dhe standarde në operacionet e tyre.

Për më tepër, Mekanizmi i Rregullimit Kufitar të Karbonit (CBAM), i prezantuar sipas Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, i cili hyri në fuqi që nga tetori i vitit 2023, do të vendosë standarde të reja dhe do të imponojë kosto mbi eksportet e produkteve të caktuara nga furnizuesit kryesorë të BE, përfshirë Kinën. Nga një perspektivë gjeostrategjike, përtej pikëpamjes liberale, varësia e BE-së nga Kina për mallra të prodhuara dhe disa minerale thelbësore shihet si një dobësi dhe jo si një mundësi.

Gjatë pandemisë COVID-19, ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit global, veçanërisht për produktet nga Kina, e vendosën BE-në në një pozicion sfidues. Josep Borrell, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë në atë kohë, theksoi këtë varësi të rrezikshme: “Ne jemi jashtëzakonisht të varur nga Kina për sa i përket importeve të një numri produktesh, veçanërisht maskave dhe veshjeve mbrojtëse (50%). Përveç kësaj, 40% e antibiotikëve të importuar nga Gjermania, Franca dhe Italia vijnë nga Kina, e cila prodhon 90% të penicilinës së konsumuar në botë. Asnjë gram paracetamol nuk prodhohet në Evropë për momentin”²⁷.

Kjo mbështetje tek Kina, edhe për fusha kritike si farmaceutika dhe lëndët e para thelbësore, e ka bërë BE-në shumë të cënueshme në kohë krize dhe në konkurrencën gjeo-ekonomike. Rritja e hendekut tregtar me Kinën dhe konkurrenca e pandershme me të cilën përballen kompanitë e BE-së në tregun kinez e kanë komplikuar më tej këtë marrëdhënie. Nga njëra anë, Kina është partneri i dytë më i madh tregtar i BE-së pas SHBA-ve, duke u renditur e para për importet dhe e treta për eksportet. Në vitin 2023, deficitin tregtar i BE-së me Kinën arriti në 292 miliardë euro²⁸.

Ndonëse shkëputja e plotë e varësisë nga Kina në afat të shkurtër kohor nuk është i realizueshëm, rëndësia e gjetjes së partnerëve alternativë është rritur, e reflektuar në koncepte si “near shoring”, “reshoring” dhe “friends

27 Josep Borrell, “The post-corona virus world is already here”, ECFR Policy Brief, 30 April 2020. URL: https://ecfr.eu/publication/the_post_coronavirus_world_is_already_here/

28 European Commission, “EU trade relations with China. Facts, figures and latest developments.” URL: https://policy.trade.ec.europa.eu/eu-trade-relationships-country-and-region/countries-and-regions/china_en#:~:text=China%20is%20the%20EU's%20second,and%20the%20biggest%20for%20imports.

shoring”. Komisioni Evropian e theksoi këtë në rishikimin e tij të politikës tregtare të BE-së: “Ndërtimi i një marrëdhënie ekonomike më të drejtë dhe të bazuar në rregulla me Kinën është një prioritet. Komunikimi përcakton mënyrat për të adresuar kompleksitetin e marrëdhënieve me Kinën dhe për të siguruar që BE-ja të ketë efektivitet në përzgjedhjen e mjeteve politike për forcimin e drejtave të saj”²⁹.

Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAC) përmbledh perspektivën e BE-së për Kinën si më poshtë:

“BE e sheh Kinën si një partner për bashkëpunim, një konkurrent ekonomik dhe një rival sistematik. Megjithatë, marrëdhëniet BE-Kinë janë bërë gjithnjë e më komplekse për shkak të një numri në rritje të faktorëve “irritues”. Kina është bërë më pak e hapur ndaj botës dhe më represive në vend, ndërkohë që ka marrë një qëndrim më këmbëngulës jashtë vendit, duke u mbështetur tek masat e detyrimit ekonomik, bojkotimit të mallrave europiane dhe kontrollit të eksportit të lëndëve të para kritike”³⁰.

Në njërën anë, hendeku tregtar i BE-së me Kinën në mallra vazhdon të rritet; në anën tjetër, rritja e konkurrencës së Kinës në sektorët teknologjikë ku BE-ja synon të jetë lider, si automjetet elektrike dhe panelet diellorë, paraqet një sfidë të rëndësishme për ambiciet e BE-së. Në vitin 2023, Kina ishte burimi më i madh i importeve për BE-në nga jashtë BE-së, duke përbërë 20.5% të totalit, ndërsa renditej e treta si destinacion për eksportet e BE-së, me 8.8%. Në vitin 2022, deficiti tregtar i BE-së me Kinën ishte 397 miliardë euro, duke rënë me 27% në vitin 2023, në 291 miliardë euro. Disa nga importet kryesore nga Kina janë pajisjet e telekomunikacionit, makineritë dhe pajisjet elektrike, si dhe makineritë për përpunimin automatik të të dhënave. Veçanërisht, automjetet treguan rritjen më të lartë të importeve, duke u rritur me 36.7%.

Marrëdhëniet e përfitimit reciprok BE-Kinë

Rendi liberal botëror, ku BE-ja ishte një lojtar kyç, synonte të integronte Kinën përmes tregtisë së lirë dhe investimeve. Një moment kyç në këtë integrim ishte anëtarësimi i Kinës në organizata ndërkombëtare si Organizata Botërore e Tregtisë dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, së bashku me miratimin e parimeve të ekonomisë së tregut. Megjithatë, modeli kapitalist shtetëror i Kinës, i cili përfshin mbështetje të konsiderueshme industriale, subvencione dhe praktika të dumping, shkaktoi reagime, sidomos nga Perëndimi dhe SHBA-të.

²⁹ European Commission, “Questions and Answers: An open, sustainable and assertive trade policy”, 18 February 2021. URL: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ganda_21_645

³⁰ European External Action Service, EU-China Relations factsheet, 7 December 2023. URL: https://www.eeas.europa.eu/eeas/eu-china-relations-factsheet_en

Duke kombinuar avantazhin e saj në fuqinë punëtore me aftësitë dhe njohuritë teknologjike know-how që janë gjithnjë në rritje, Kina ka forcuar vazhdimisht pozitat e saj në tregtinë botërore, duke intensifikuar konkurrencën. Njëkohësisht, përplasia në rritje midis SHBA-së dhe Kinës, së bashku me masat mbrojtëse tregtare që synojnë kufizimin e praktikave të padrejta konkurruese të Kinës, ka krijuar një ndarje gjeopolitike, e cila është përshkallëzuar më tej nga çështje si Tajvani dhe lufta në Ukrainë.

Nga ana tjetër, BE-ja ka mbajtur një qëndrim më të moderuar mes të tensioneve në rritje ndërmjet Kinës dhe SHBA-ve. Duke qenë të kujdesshëm që të mos rrezikojnë lidhjet e rëndësishme tregtare dhe ekonomike me Kinën, liderët e BE-së nga vende kyçe si Gjermania dhe Franca vizituan Kinën në vitin 2023, duke shprehur angazhimin për të ruajtur këtë marrëdhënie mes tyre. Gjatë vizitës së tij me një delegacion të madh biznesi, kancelari gjerman Olaf Scholz nënvizoi jo vetëm vlerën e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike me Kinën, por edhe nevojën për një fushë loje të barabartë për kompanitë gjermane. Subvencionet e gjera të Kinës dhe praktikat e dumpingut – të tilla si në sektorin e automjeteve elektrike – shpesh nxisin kundërmasa nga BE.

Liderët europianë i kanë fokusuar përpjekjet e tyre diplomatike në nxitjen e Kinës që të braktisë këto praktika, të cilat mund të shihen si shkelje e rregullave të OBT-së dhe për të nxitur një mjedis më të drejtë investimi për investitorët europianë. Një çështje tjetër e spikatur gjatë vizitës së presidentit francez Macron në Kinë – dhe më vonë gjatë vizitës së Xi Jinping në Francë – ishte mbështetja e Kinës për Rusinë në luftën e Ukrainës. Nëpërmjet tregtisë së vazhdueshme dhe bashkëpunimit të ngushtë me Rusinë, Kina po mbështet në mënyrë efektive Rusinë kundër BE-së dhe SHBA-së, duke ndihmuar në ruajtjen e aftësisë së Rusisë për të vazhduar konfliktin në Ukrainë.

Ndërsa BE-ja tradicionalisht i ka dhënë përparësi tregtisë si boshtit të saj më të fortë, konsideratat gjeopolitike janë bërë gjithnjë e më dominuese, duke reflektuar ndryshime më të gjera globale. Përdorimi i fuqisë ekonomike nga ana e Kinës për të zgjeruar ndikimin e saj dhe për të imponuar vullnetin e saj te kombet e tjera, shtrirja e saj në Evropë përmes projekteve si Iniciativa “Një Brez, një Rrugë” dhe ndikimi i saj jo vetëm ekonomikisht, por edhe politikisht dhe kulturalisht përmes investimeve strategjike janë parë gjithnjë e më shumë si kërcënime potenciale nga BE-ja.

Për të adresuar këtë, BE-ja ka prezantuar ligje të reja që kërkojnë që investimet strategjike t’i nënshtrohen monitorimit dhe shqyrtimit, duke zvogëluar në mënyrë efektive investimet kineze në sektorë kritikë. Hetimet mbi automjetet elektrike kineze, sanksionet kundër firmave të energjisë diellore në pronësi kineze dhe shqetësimet mbi fushatat e dezinformimit të Kinës kanë komplikuar më tej marrëdhëniet BE-Kinë. Një herë e një kohë

e konsideruar si një fuqi ekonomike në rritje e fokusuar vetëm në prodhim dhe shitje, Kina sot shihet si një fuqi globale e lidhur me Rusinë në një bosht antiperëndimor dhe kritikohet gjithnjë e më shumë për veprimet e saj represive kundër disidentëve, turqve ujqurë dhe Hong Kongut.

Por, a është e mundur për BE-në të ruajë një marrëdhënie të përfitimeve të ndërsjella për të dyja palët me Kinën, duke vendosur si prioritet interesat ekonomike? Peng Gang, ministër për Çështjet Ekonomike dhe Tregtare në Misionin Kinez në BE, argumenton se tregtia ndërmjet BE-së dhe Kinës është me leverdi për të dyja palët:

“Importet e Kinës nga BE-ja kanë përmirësuar shëndetin dhe standardet e jetesës së qytetarëve kinezë dhe kanë shtuar zhvillimin ekonomik të Kinës. Njëkohësisht, eksportet nga Kina të produkteve të energjisë së rinovueshme, elektronikës dhe mallrave të tjera drejt BE-së kanë përshpejtuar kalimin e Europës në një ekonomi të gjelbër dhe digjitale dhe kanë ndihmuar në uljen e nivelit të inflacionit në BE. Tregtia ndërmjet Kinës dhe BE-së është e dobishme për të dyja palët”³¹.

Peng gjithashtu vë në pikëpyetje strategjinë e reduktimit të rrezikut të BE-së që ka si synim zhvendosjen e zinxhirëve të furnizimit në vendet që territorialisht ndodhen më afër BE-së. Duke theksuar natyrën komplementare të ekonomive kineze dhe të BE-së, ai argumenton se Kina kundërshton politizimin e çështjeve ekonomike, duke shtuar: “Është mungesa e bashkëpunimit që paraqet rrezikun më të madh dhe mungesa e zhvillimit që paraqet pasigurinë më të madhe”.

Që nga viti 2023, investimet e ndërsjella BE-Kinë kanë tejkaluar 250 miliardë dollarë. Investimet e BE-së në Kinë u rritën me 5.5% nga viti në vit deri në 10.6 miliardë dollarë, ndërsa investimet kineze në BE u rritën me 17.4% deri në 8.2 miliardë dollarë. Që nga viti 2022, kompanitë e mëdha si BMW, VW, Stellantis dhe BASF kanë zgjeruar investimet e tyre në tregun kinez, ndërsa 80% e kompanive kineze kanë shprehur synimet për të rritur investimet e tyre në Europë. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga rreziqet gjeopolitike, marrëdhëniet e ndërsjella tregtare mbeten të dobishme për të dyja palët.

Megjithatë, mjedisi global gjithnjë e më i pasigurt – i shënuar nga pandemia COVID-19 dhe konfliktet pasuese në Ukrainë dhe Gaza – ndërlikon përpjekjet për të menaxhuar këto marrëdhënie bazuar vetëm në interesat ekonomike.

³¹ Peng Gang, “The Essence of China-EU Trade and Economic Relations is Mutual Benefit and Win-Win”, Euractiv, 8 April 2024. URL: <https://www.euractiv.com/section/eu-china/opinion/the-essence-of-china-eu-trade-and-economic-relations-is-mutual-benefit-and-win-win/>

Rëndësia e marrëdhënieve BE-Kinë për rendin global

Vazhdimi i marrëdhënieve të forta tregtare dhe ekonomike midis Kinës dhe BE-së është thelbësor për ruajtjen e një sistemi global që po polarizohet gjithnjë e më shumë. Modeli i qeverisjes autoritare të Kinës, i cili i jep përparësi konceptit të komunitetit mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, nxjerr në pah një divergjencë të konsiderueshme nga parimet dhe vlerat thelbësore të BE-së.

Në këtë kontekst, roli i Kinës si një nga partnerët më të mëdhenj të tregtisë dhe investimeve të BE-së nënvizon një kontradiktë të madhe midis vlerave normative të BE-së dhe interesave të saj ekonomike në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikës së jashtme. Kjo kontradiktë, e përmbledhur në konceptin e “pragmatizmit parimor”³², të prezantuar në Strategjinë e Sigurisë së BE-së 2016, e bën gjithnjë e më sfiduese për BE-në të pajtojë vlerat e saj me realitetet komplekse të një bote, ku rendi liberal po “gërryhet” gradualisht.

Megjithëse BE-ja ka vendosur sanksione të caktuara ndaj Kinës, të tilla si ato që kanë në shënjestër automjetet elektrike, shkalla e investimeve të vazhdueshme të ndërsjella nxjerr në pah kontradiktën e Bashkimit Europian, i cili pozicionohet si një fuqi normative me një politikë të jashtme të bazuar në të drejtat e njeriut dhe respektimin e të drejtës ndërkombëtare.

Në të njëjtën kohë, Kina mbetet një partner kritik që BE-ja nuk mund ta zëvendësojë lehtësisht në shumë sektorë. Për më tepër, qëndrimi i SHBA-së për përcaktimin e Kinës si një kundërshtar - një ndryshim që u bë i dukshëm gjatë presidencës së Trump - ka kufizuar hapësirën e manovrimit të BE-së dhe ka rritur fokusin e saj në sigurinë ekonomike.

Kina luan një rol qendror në boshtin anti-perëndimor, duke mbështetur Rusinë dhe duke zgjeruar ndikimin e saj ekonomik dhe politik përmes formatit BRICS. Vazhdimi i marrëdhënieve të ngushta BE-Kinë – të cilat i kanë mundësuar Kinës të rrisë kapacitetin e saj të inovacionit në teknologjitë e reja, hapësirën kozmike dhe ushtrinë, duke e pozicionuar Kinën si një lidere botërore dhe jo thjesht si një sfiduese të SHBA-ve – mbështetet në disa kushte. Kryesorja ndër këto janë prioritetet e respektit të ndërsjellë dhe fokusi i përbashkët në interesat ekonomike. Megjithatë, në një mjedis të tensioneve gjeopolitike në rritje, bëhet gjithnjë e më i vështirë izolimi i politikës nga veprimet që mund të dëmtojnë ndjeshëm BE-në. Nëse konfliktet në Lindjen e Mesme ose Euroazi intensifikohen dhe tendosin më tej marrëdhëniet Kinë-Perëndim, ose nëse çështje si Tajvani çojnë në një krizë SHBA-Kinë, marrëdhëniet BE-Kinë do të zhvendoseshin në mënyrë të pashmangshme në një drejtim dukshëm të ndryshëm.

32 European External Action Service, “Shared Vision, Common Action: A Stronger Europe”, June 2016. URL: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/eugs_review_web_0.pdf

Në një skenar të tillë, strategjitë si vendosja e sanksioneve ose zvogëlimi i marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike – siç shihet në rastin e Rusisë – do të ishin shumë sfiduese për BE-në për shkak të rolit jetik të lidhjeve tregtare me Kinën. Mes tensioneve të intensifikuara SHBA-Kinë, përpjekja e BE-së për të mbajtur një qëndrim të ekuilibruar, në vend që të përafrohet plotësisht me njërin palë, ka të ngjarë të bëhet e paqëndrueshme përballë një krize gjeopolitike. Megjithatë BE-ja po punon për të reduktuar varësinë e saj nga Kina, veçanërisht referuar mallrave të prodhuara, nuk ka gjasa të gjejë një alternativë afatshkurtër që do të zëvendësojë plotësisht Kinën. Nëse një krizë shkakton një tjetër përçarje në marrëdhëniet BE-Kinë, të ngjashme me ndikimin e COVID-19, ajo mund të përbëjë rreziqe serioze për ekonominë europiane.

Turqia mes BE-së dhe Kinës

Përkeqësimi i marrëdhënieve BE-Turqi, veçanërisht që nga viti 2018, dhe pezullimi i procesit të anëtarësimit kanë anashkaluar gradualisht objektivin e anëtarësimit të Turqisë në BE, duke sjellë në plan të parë aspiratat alternative, siç është anëtarësimi i mundshëm në BRICS.

Megjithatë, tregu i BE-së mbetet vendimtar për Turqinë, veçanërisht për eksportet, me rreth 41% të eksporteve turke që shkojnë në BE – kryesisht në Gjermani. Kapitali europian luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në investimet direkte në Turqi, duke theksuar se një zhvendosje e menjëhershme e Turqisë drejt tregjeve alternative nuk është e realizueshme.

Turqia është një partner i rëndësishëm për Kinën, e cila po zgjeron rolin e saj ekonomik global përmes nismave si “Një Brez, një Rrugë” dhe po rrit ndikimin e saj në të gjithë Azinë, Afrikën dhe Europën me investime, veçanërisht në infrastrukturë, porte dhe industrinë e prodhimit. Megjithatë, rëndësia strategjike e Turqisë për Kinën rrjedh kryesisht nga aksesimi që Turqia ka në Europë. Për sa i përket tregtisë, ndërkohë që vëllimi i përgjithshëm tregtar ndërmjet këtyre dy vendeve është rritur, ai ka rezultuar vazhdimisht në një suficit tregtar në favor të Kinës. Në vitin 2023, eksportet e Turqisë në Kinë arritën në 3.31 miliardë dollarë, duke përbërë 1.3% të totalit të eksporteve të saj, ndërsa eksportet në Gjermani ishin 21.83 miliardë dollarë, ose 8.2% e totalit.

Nga ana e importit, Kina renditet e para, me importe që arrijnë në 45.48 miliardë dollarë, që përfaqësojnë 12.4% të totalit të importeve të Turqisë. Ndërsa Kina është burimi më i madh i importeve të Turqisë, ajo renditet e 19-ta ndër destinacionet kryesore të eksportit të Turqisë³³, duke theksuar një çekuilibër tregtar që Turqia po përpriqet ta rregullojë. Megjithatë, rritja e

³³ The Republic of Turkey, Ministry of Trade, “Foreign Trade Statistics”. URL: <https://www.>

eksporteve drejt Kinës për një afat të shkurtër kohor nuk ka gjasa të ndodhë, duke pasur parasysh prodhimin e mallrave shumë konkurrues të Kinës për tregjet globale. Kështu, bashkëpunimi me Kinën në infrastrukturë, transport, teknologji të lartë, energji dhe financa do të jetë gjithnjë e më kritik, veçanërisht pasi Turqia kërkon më shumë investime të huaja.

Për Turqinë, çështja e ujugurëve mbetet një aspekt domethënës i dimensionit normativ në marrëdhëniet e saj me Kinën. Ndërsa qeveria përmbahet nga kritikata e hapura ndaj shtypjes dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut me të cilat përballen turqit ujugurë, Ministria e Punëve të Jashtme e Turqisë thekson se “Pritshmëritë dhe ndjeshmëritë tona që turqit ujugurë të jetojnë në mirëqenie dhe paqe dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të tyre themelore janë theksuar si në kontaktet tona dypalëshe me autoritetet e Republikës Popullore të Kinës, ashtu edhe në platformat ndërkombëtare, veçanërisht në Organizatën e Kombeve të Bashkuara”³⁴, duke dëshmuar se kjo çështje nuk është plotësisht e shpërfillur në marrëdhëniet mes dy palëve.

Gjatë vizitës së tij të fundit në Kinë, Ministri i Jashtëm turk Hakan Fidan vizitoi Xhaminë Yanghang dhe Pazarin e Madh Ndërkombëtar në Urumqi, kryeqyteti i Rajonit Autonom Ujgur të Xinjiang-ut, duke nënvizuar rëndësinë që ka çështja e ujugurëve për Turqinë. Megjithatë, duhet theksuar se natyra autoritare e Kinës nuk duket se përbën një konflikt të rëndësishëm normativ për qeverinë turke, e cila përgjatë veprimtarisë së saj duket se i është larguar modelit liberal demokratik.

Kina mund të shihet gjithashtu si një burim frymëzimi, veçanërisht si një model në fusha si mbrojtja e të drejtave individuale në sferën dixhitale dhe implementimin e standardeve të punës. Megjithëse BE-ja e konsideron Kinën si “një konkurrente ekonomike dhe një rivale sistematike”, ajo mbetet një partner ekonomik tërheqës, burim investimesh dhe model zhvillimi për Turqinë. Megjithatë, kushtet e veçanta kulturore, politike, gjeografike dhe ekonomike të Kinës, e pengojnë atë të jetë një model i kompletuar. Ndërsa këndvështrimi pragmatik i Kinës përputhet me prioritetet e zhvillimit dhe rritjes së Turqisë, asimetria në marrëdhëniet e tyre thekson gjithashtu rreziqet strategjike që mund të pasojnë për Turqinë në të ardhmen.

Bibliografia

Josep Borrell, “The post-corona virus world is already here”, ECFR Policy Brief, 30 April 2020. URL: https://ecfr.eu/publication/the_post_coronavirus_trade.gov.tr/statistics/foreign-trade-statistics

34 QA-25, 8 September 2022, Statement of the Spokesperson of the Ministry of Foreign Affairs, Ambassador Tanju Bilgiç, in Response to a Question Regarding the Report Released by the Office of the UN High Commissioner for Human Rights on the Human Rights Situation in the Xinjiang Uyghur Autonomous Region of the People's Republic of China (PRC).

world_is_already_here/

European Commission, “EU trade relations with China. Facts, figures and latest developments.” URL: https://policy.trade.ec.europa.eu/eu-trade-relationships-country-and-region/countries-and-regions/china_en#:~:text=China%20is%20the%20EU's%20second,and%20the%20biggest%20for%20imports.

European Commission, “Questions and Answers: An open, sustainable and assertive trade policy”, 18 February 2021. URL: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_645

European External Action Service, EU-China Relations factsheet, 7 December 2023. URL: https://www.eeas.europa.eu/eeas/eu-china-relations-factsheet_en

Peng Gang, “The Essence of China-EU Trade and Economic Relations is Mutual Benefit and Win-Win”, Euractiv, 8 April 2024. URL: <https://www.euractiv.com/section/eu-china/opinion/the-essence-of-china-eu-trade-and-economic-relations-is-mutual-benefit-and-win-win/>

European External Action Service, “Shared Vision, Common Action: A Stronger Europe”, June 2016. URL: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/eugs_review_web_0.pdf

The Republic of Turkey, Ministry of Trade, “Foreign Trade Statistics”. URL: <https://www.trade.gov.tr/statistics/foreign-trade-statistics>

QA-25, 8 September 2022, Statement of the Spokesperson of the Ministry of Foreign Affairs, Ambassador Tanju Bilgiç, in Response to a Question Regarding the Report Released by the Office of the UN High

Çështje aktuale të së drejtës penale për të miturit në Austri

Besmir Premalaj PhD
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
besmir.premalaj@umsh.edu.al

Abstrakt

Objektivi kryesor i ligjit penal, si dhe i sanksioneve të vendosura për shkelje të kodit penal, është të kryejë një funksion të dyfishtë: së pari, të pengojë individët nga përfshirja në sjellje kriminale nëpërmjet masave parandaluese dhe frikësuese dhe së dyti, të lehtësojë rehabilitimin të shkelësit. Aspekti rehabilitues merr një rëndësi të veçantë kur shkelësi është i mitur, pasi përputhet me qëllimin më të gjerë shoqëror për riintegrimin e individëve të rinj në shoqëri. Në Shqipëri, së fundmi janë miratuar reforma të rëndësishme ligjore në këtë fushë, të cilat kulmuan me miratimin e Kodit të Drejtësisë për të Miturit, i cili përfaqëson një kodifikim gjithëpërfshirës të ligjeve që kanë të bëjnë me të miturit. Shumë vende evropiane kanë përvojë të gjerë në zhvillimin e kornizave ligjore që adresojnë drejtësinë për të miturit, duke e bërë të domosdoshme shqyrtimin dhe nxjerrjen e njohurive nga sistemet e tyre përkatëse.

Austria përfaqëson një shembull të rëndësishëm brenda Evropës, pasi sistemi i saj ligjor dallon qartë përgjegjësinë penale të të miturve bazuar në zhvillimin psiko-social. E drejta penale austriake i klasifikon shkelësit në tre kategori sipas moshës: të mitur të papjekur, të mitur të pjekur dhe individë me përgjegjësi të plotë penale. Për më tepër, edhe në mesin e atyre me përgjegjësi të plotë penale, legjislati austriak prezanton dallime në bazë të moshës në përcaktimin e sanksioneve të duhura.

Ky studim synon të shqyrtojë dallimet në trajtimin penal të shkelësve sipas ligjit austriak, duke lehtësuar kështu një analizë krahasuese të penalizimit të të miturve brenda kuadrit ligjor të Shqipërisë dhe Austrisë.

Fjalë kyçe: të mitur të papjekur, të mitur të pjekur, rehabilitim i subjektit të së drejtës.

Abstract

The principal objective of criminal law, as well as the sanctions imposed for breaches of the criminal code, is to serve a dual function: firstly, to deter individuals from engaging in criminal behavior through preventive and intimidatory measures, and secondly, to facilitate the rehabilitation of the offender. The rehabilitative aspect assumes particular importance when the offender is a minor, as it aligns with the broader societal goal of reintegrating

young individuals into society. In Albania, significant legal reforms have recently been enacted in this domain, culminating in the adoption of the Juvenile Justice Code, which represents a comprehensive codification of laws pertaining to minors. Numerous European countries possess extensive experience in developing legal frameworks addressing juvenile justice, making it imperative to examine and draw insights from their respective systems.

Austria represents a noteworthy example within Europe, as its legal system distinctly differentiates juvenile criminal responsibility based on psycho-social development. Austrian criminal law classifies offenders into three categories according to age: immature minors, mature minors, and individuals with full criminal responsibility. Furthermore, even among those with full criminal liability, Austrian legislation introduces distinctions based on age in determining appropriate sanctions.

This study aims to examine the distinctions in the penal treatment of offenders under Austrian law, thereby facilitating a comparative analysis of juvenile penalization within the legal frameworks of Albania and Austria.

Key words: immature minors, mature minors, rehabilitation of the subject of law.

1. Dënimi penal dhe masat parandaluese

E drejta penale austriake bazohet në sistemin e dualizmit. Sipas këtij sistemi dhomat penale të gjykatave mund të japin, ose dënim penal, ose masa parandaluese në rast të kryerjes së një vepre penale. Ideatori dhe përfaqësues kryesor i sistemit të dualizmit është zviceriani *Carl Stooss*. Ky sistem u zbatua më vonë në Austri me hyrjen në fuqi të kodit penal të 1975 dhe përbën tashmë bazat e legjislacionit penal të vendeve të Evropës dhe Amerikës Latine.³⁵

Dënimi penal

Dënimi penal është ndëshkimi i parashikuar në kodin penal dhe i dhënë nga trupi gjykues i gjykatës penale për shkak të një veprimi të palejuar, në varësi të fajit të të akuzuarit. Faji është jo vetëm parakusht, por njëkohësisht edhe kufiri në dhënien e dënimit.³⁶ Për këtë arsye niveli i dënimit nuk duhet të kalojë nivelin e fajit të të akuzuarit.

Qëllimi i dhënies së dënimit është, nga njëra anë, shpagimi për kryerjen e një veprimi të parashikuar në dispozitat e kodit penal dhe nga ana tjetër,

³⁵ *Jescheck/Weigend*, Lehrbuch des Strafrechts, Allgemeiner Teil⁵ (1996) 84.

³⁶ *Kienapfel/Höpfel*, Strafrecht, Allgemeiner Teil¹⁰ (2003) Z2 RN 1.

parandalimi i përgjithshëm dhe ai i veçantë në kryerjen e një vepre penale. Ideja e shpagimit bazohet në idetë filozofike të *Kantit*, sipas të cilës, secili duhet të përballet me pasojat e veprimeve të tij. Shpagimi njihet ndryshe në terminologjinë e të drejtës edhe si baraspeshimi i drejtë i fajit me dënimin. Sipas *Jescheck* baraspeshimi i drejtë i fajit me dënimin ndihmon në ri-integrimin e të dënuarit në shoqëri.

Qëllimi i parandalimit të përgjithshëm është efekti edukues i dënimit në shoqëri. Sipas këtij nocioni dhënia e dënimeve penale, ose rreziku i dënimit që vjen nga kryerja e një vepre penale, shërben si kundërpeshë dhe si një mjet frikësues për të tjerët në kryerjen e veprimeve që bien ndesh me kodin penal. Doktrina e të drejtës penale bën dallimin midis parandalimit të përgjithshëm negativ dhe parandalimit të përgjithshëm pozitiv. Në parandalimin e përgjithshëm negativ synohet frikësimi i shoqërisë në kryerjen e veprave penale nëpërmjet frikës nga marrja e një dënimi. Ndërsa sipas parandalimit të përgjithshëm pozitiv, ekzistenca e kërcënimit me dënime sipas së drejtës penale dhe veprimtaria e organeve ligj zbatuese, jo vetëm shton bindjen e shoqërisë ndaj normave ligjore, por rrit edhe besimin e saj në zbatimin e barabartë të ligjit dhe në shtetin ligjor. Pra shërben si një mjet bindjeje shoqërore ndaj normave të së drejtës. Në këtë drejtim mund të shihet aspekti i kënaqësisë së shoqërisë dhe qetësisë të ndërgjegjes së saj me dënimin e të pandehurit për shkak të thyerjes së ligjit.³⁷

Mendimi filozofik i parandalimit të veçantë orientohet tek rrezikshmëria e individit në vetvete. Sipas saj dënimet penale jepen në mënyrë që të dekurajojnë të pandehurit që të kryejnë vepra penale në të ardhmen dhe t'i edukojnë ato të sillen në mënyrë ligjore. Ideator i kësaj teorie penale është austriaku *Franz von Liszt*, i cili e ka sjellë këtë teori në qendër të politikave racionale të së drejtës.³⁸

Në praktikë të tre këto teori u bashkuan në një, si tre synimet kryesore të së drejtës penale. Kështu synimi i dhënies së dënimit penal është parandalimi i përgjithshëm dhe ai i veçantë, si dhe synimi i shpagimit për shkak të kryerjes së një veprimi të parashikuar në dispozitat e kodit penal. Paragrafët e kodit penal austriak i referohen *expressis verbis* vetëm teorisë së parandalimit të përgjithshëm dhe atij të veçantë. Megjithatë dënimi penal perceptohet si nga i pandehuri, ashtu edhe nga shoqëria, si shpagim për kryerjen e veprës penale.

Masat parandaluese

Masat parandaluese janë sanksionet që jepen pavarësisht fajit të të pandehurit. Dhënia e tyre lidhet më shumë me rrezikshmërinë që mbart

³⁷ *Roxin*, Strafrecht, Allgemeiner Teil I, Grundlagen, Der Aufbau der Verbrechenslehre³ (1997) § 3 RN 27.

³⁸ *Franz von Liszt*, Marburger Programm (1882).

vetë i pandehuri në shoqërori.³⁹ Këto janë masa që jepen për të pandehur që mbartin rrezikshmëri shoqërore për shkak të prirjeve të tyre ndaj drogërave, prirjeve seksuale ose sëmundjeve mendore. Kryerja e një vepre penale është gjithashtu parakusht për dhënien e masave parandaluese.

Ndryshe nga dënimet penale, synimi i masave parandaluese është luftimi i rrezikshmërisë shoqërore të sjelljes së një të pandehuri të caktuar. Masat parandaluese nuk kanë qëllimin e parandalimit të përgjithshëm, por atë të parandalimit të veçantë të lidhur me veprimin e një të pandehuri me karakteristika të caktuara dhe jepen vetëm për të pandehur me rrezikshmëri të veçantë. Në këtë aspekt duhet të mbahet gjithmonë parasysh parimi i baraspeshimit (proporcionalitetit).⁴⁰ Ndërsa dënimi penal ka karakter retrospektiv, masat parandaluese orientohen drejt të ardhmes, konkretisht drejt rrezikshmërisë në të ardhmen të një të pandehuri konkret.

Tre janë llojet e heqjes së lirisë nëpërmjet masave parandaluese në kodin penal austriak:

1. mbyllja në institucione për persona me çrregullime psikike⁴¹,
2. mbyllja në institucione rehabilituese⁴² dhe
3. mbyllja në institucione për shkelës përsëritës⁴³.

Qëllimi kryesor i masave parandaluese nuk është heqja e lirisë së subjektit të së drejtës, por rehabilitimi i një personi që mbart rrezikshmëri shoqërore. Megjithatë masat parandaluese janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me heqjen, ose kufizimin e lirisë së personit. Qëllimi nuk është heqja e lirisë, por kjo heqje e lirisë është pasojë e pashmangshme e vendosjes së masave parandaluese.⁴⁴ Në varësi të veprës penale mund të jepen njëkohësisht dënime penale të shoqëruara me masa parandaluese, nëse në një rast konkret ka një kombinim të fajit me rrezikshmërinë e veçantë shoqërore të të pandehurit. Për shembull një i pandehur që ka varësi nga droga duhet jo vetëm të dënohet me heqje lirie, por të dërgohet edhe në një institucion rehabilitues për personat e varur nga drogërat.

2. Dënueshmëria penale për të miturit

E drejta penale austriake e rregullon penalitetin e të miturve në një ligj të veçantë, ligji datë 20.10.1988 “Mbi zbatimin e ligjit për vepra penale nga të mitur” (Jugendgerichtsgesetz). Subjektet e të drejtës penale në të drejtën penale austriake kategorizohen, në varësi të moshës, në tre grupe: në të mitur

39 *Kienapfel/Höpfel*, Strafrecht, Z2 RN 12.

40 *Ratz* in Wiener Kommentar zum Strafgesetzbuch², hrsg. Höpfel/Ratz (1999) § 23 RN 6.

41 § 21 i kodit penal austriak.

42 § 22 i kodit penal austriak.

43 § 23 i kodit penal austriak.

44 *Kienapfel/Höpfel*, Strafrecht, Z2 RN 16.

të papjekur, të mitur të pjekur dhe në persona me përgjegjësi të plotë penale. Të miturit e papjekur janë të mitur që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç. Sipas ligjit datë 20.10.1988 “Mbi zbatimin e ligjit për vepra penale nga të mitur” (Jugendgerichtsgesetz) të miturit e papjekur nuk kanë përgjegjësi penale si në rast të kryerjes së një krimi, ashtu edhe të kryerjes së një kundërvajtje penale.⁴⁵

Të miturit e pjekur janë të mitur që kanë mbushur moshën 14 vjeç, por jo atë 18 vjeç. Ato kanë përgjegjësi penale si në rast të kryerjes së një krimi, ashtu edhe të kryerjes së një kundërvajtje penale. Megjithatë të miturit e pjekur përjashtohen nga përgjegjësia penale, nëse ato nuk janë mjaftueshëm të pjekur që të kuptojnë padrejtësinë e veprimit të kryer.⁴⁶ Po ashtu një i mitur i pjekur nuk ka përgjegjësi penale, nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto tre kushte: i mituri i pjekur ka kryer një kundërvajtje penale pa mbushur moshën 16 vjeç, faji i tij në kryerjen e kundërvajtjes penale nuk është aq i rëndë dhe dënimi i të miturit nuk do të plotësonte qëllimin e parandalimit të veçantë, pra nuk do të kishte efekt edukues për të miturin në moskryerjen në të ardhmen të një veprë penale.⁴⁷

Siç shihet e drejta penale austriake ashtu si ajo shqiptare bën dallimin në përgjegjësinë penale midis krimit dhe kundërvajtjes penale, në rast të kryerjes së saj nga një i mitur. Sipas kodit penal shqiptar një i mitur, që nuk ka mbushur moshën 16 vjeç, nuk ka përgjegjësi penale, nëse kryen një kundërvajtje penale. Ndërsa e drejta penale austriake i jep përgjegjësi penale edhe një të mituri që nuk ka mbushur moshën 16 vjeç dhe që ka kryer një kundërvajtje penale, nëse nuk plotësohen në mënyrë kumulative tre kushtet e përmendura më lart.

E drejta penale austriake bën dallim edhe në masën e dënimit penal, në rast të kryerjes së veprës penale nga një i mitur. Kështu në vend të dënimit me jetë, ose të masës së dënimit nga 10 deri në 20 vite heqje lirie, një i mitur i pjekur që ka mbushur moshën 16 vjeç dënohet nga 1 deri në 15 vite heqje lirie. Ndërsa një i mitur që nuk ka mbushur ende moshën 16 vjeç, në vend të dënimit me jetë, ose të masës së dënimit nga 10 deri në 20 vite heqje lirie, dënohet me 1 deri në 10 vite heqje lirie.⁴⁸

Masa e dënimit për një veprë penale, që dënohet nga 10 deri në 20 vite heqje lirie, ulet për të miturit në 6 muaj deri në 10 vite.⁴⁹ Në të gjitha rastet e tjera masa e dënimit për të miturit përgjysmohet dhe nuk ka një kufi të

45 § 4 Abs. 1 Jugendgerichtsgesetz.

46 § 4 Abs. 2 Z 1 Jugendgerichtsgesetz.

47 § 4 Abs. 2 Z 2 Jugendgerichtsgesetz.

48 § 5 Abs. 2 Jugendgerichtsgesetz

49 § 5 Abs. 3 Jugendgerichtsgesetz

poshtëm në dhënien e dënimit.⁵⁰

Nëse një i mitur që ka mbushur moshën 14 vjeç kryen një veprë penale për të cilën masa e dënimit e parashikuar në kodin penal është relativisht e vogël, gjykata duhet të shprehet në vendimin përkatës vetëm mbi fajësinë e të miturit dhe nuk duhet të përfshijë në të dhënien e masës së dënimit. Kjo vetëm, nëse vendimi mbi fajësinë e të miturit mjafton për të arritur qëllimin e parandalimit të veçantë, pra do të kishte efekt edukues për të miturin në moskryerjen në të ardhmen të një veprë penale.⁵¹ Nëse masa e dënimit për veprën e kryer nuk është e vogël, atëherë gjykata mund të shprehet me vendim vetëm mbi fajësinë e të miturit dhe të kushtëzojë dhënien e masës së dënimit me 1 deri në 3 vite, nëse ky vendim do të kishte efekt edukues për të miturin në moskryerjen në të ardhmen të një veprë penale.⁵²

Për sa i përket çështjeve procedurale, ligji parashikon masa lehtësuese për të miturit, si në përcaktimin e kompetencës territoriale të gjykatës, ashtu edhe në gjykimin e të miturit. Kompetenca territoriale e gjykatës nuk përcaktohet sipas vendit ku është kryer vepra penale, por për të miturit, sipas vendbanimit të tyre të zakonshëm në kohën e fillimit të procedimit penal.⁵³ Po ashtu seanca gjyqësore mund të mbahet vetëm, nëse të miturit, përveç avokatëve, janë të përfaqësuar edhe nga përfaqësuesit e tyre ligjor (prindërit, etj.). Për vuajtjen e dënimit për të miturit ligji detyron mbylljen e tyre në institucione të veçanta të dënimit, ose në ambiente të ndara nga të rriturit.⁵⁴ Gjithashtu gjatë vuajtjes së dënimit të miturit i nënshtrohen një procesi të veçantë të riedukimit, duke përfshirë edhe dhënien e një profesioni të caktuar, të cilin mund ta ushtrojnë pas vuajtjes së dënimit.⁵⁵

Edhe tek personat me përgjegjësi të plotë penale e drejta austriake bën një dallim në varësi të moshës së tyre. Në llogaritjen e masës së dënimit, kodi penal austriak konsideron si rrethanë lehtësuese kryerjen e veprës penale kur i riu kishte mbushur moshën 18 vjeç, por jo atë 21 vjeç.⁵⁶

3. Përfundime

Qëllimi i të drejtës penale është parandalimi i kryerjes së veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimi, i shoqëruar me ri-integrimin e subjekteve të së drejtës penale në shoqëri. Arritja e këtij synimi është sidomos më i mundur, kur subjekti i veprës penale e kryen atë për herë të parë. Përballja e tij për herë

50 § 5 Abs. 4 Jugendgerichtsgesetz.

51 § 12 Jugendgerichtsgesetz.

52 § 13 Jugendgerichtsgesetz.

53 § 29 Jugendgerichtsgesetz.

54 § 55 Jugendgerichtsgesetz.

55 § 53 Jugendgerichtsgesetz.

56 § 34 Abs. 1 Z 1 i kodit penal austriak.

të parë me dënimin ndikon në aspektin psikologjik të subjektit të së drejtës. Ky është momenti më i mirë për ri-edukimin e tij.

Për shkak të evoluimit të tyre emocional dhe të një pike kthese në jetën e tyre, sidomos në periudhën e adoleshencës, janë pikërisht të miturit ato që përballen në përgjithësi për herë të parë me dënimin penal. Për këtë arsye, dënimi i tyre nuk është i nevojshëm të jetë i ashpër, por i mjaftueshëm për t'i frikësuar dhe detyruar ato në moskryerjen në të ardhmen të veprave penale. Siç e parashikon edhe e drejta penale austriake, në disa raste mjafton vetëm shpallja e fajësisë në vendimin përkatës, të pashoqëruar nga dhënia e një dënimi. Kjo shkakton edhe në aspektin psikologjik vënien në pah të pasojave nga kryerja e një veprimi të ndaluar, pasoja që mund të ishin më të rënda. Frikësimi nga pasojat më të rënda, detyron edhe psikologjikisht të miturit të mos kryejnë veprime të palejuara në të ardhmen.

Dhënia e dënimit penal duhet të shoqërohet edhe me masa të tjera rehabilituese. Duke qenë se, një ndër qëllimet kryesore në kryerjen e një vepre penale janë përfitimet ekonomike, që rrjedhin prej tyre dhe numri më i madh i kryerjes së veprave penale është në ato vende ku niveli ekonomik është i ulët, dhënia sidomos tek të miturit e një profesioni, që mund ta ushtrojnë në të ardhmen, mund të ndihmojë në mënyrë të qenësishme në rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Për këtë arsye është e këshillueshme, që gjatë vuajtjes së dënimit të miturit, por edhe të rriturit, t'i nënshtrohen një procesi riedukimi, që përfshin edhe dhënien e një profesioni të caktuar, të cilin mund ta ushtrojnë pas vuajtjes së dënimit. Në këtë mënyrë mund të eliminohet një nga motivet kryesore që shtyjnë subjektet e të drejtës penale në kryerjen e veprave penale.

Bibliografia

Literaturë

Franz von Liszt, Marburger Programm (1882)

Jescheck/Weigend, Lehrbuch des Strafrechts, Allgemeiner Teil, 5. Auflage (1996)

Kienapfel/Höpfel, Strafrecht, Allgemeiner Teil, 10. Auflage (2003)

Roxin, Strafrecht, Allgemeiner Teil I, Grundlagen, Der Aufbau der Verbrechenslehre, 3. Auflage (1997)

Wiener Kommentar zum Strafgesetzbuch, hrsg. Höpfel/Ratz, 2. Auflage (1999).

Legjislacion

Kodi penal austriak

Ligji datë 20.10.1988 “Mbi zbatimin e ligjit për vepra penale nga të mitur” (Jugendgerichtsgesetz)

Normat zakonore dhe rëndësia e tyre në aspektin e ndërkombëtarizimit. Rasti i Shqipërisë dhe Italisë.

Av. Fiona Tako PhD
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
fionatako@umsh.edu.al

Abstrakt

Ky punim shqyrton rolin e normave zakonore në procesin e ndërkombëtarizimit, me fokus në Shqipërinë dhe Italinë. Ai trajton ndikimin e trashëgimisë ligjore romake në të drejtën zakonore shqiptare dhe ngjashmëritë kryesore në parimet juridike, strukturat familjare dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, analizon kontributin e normave zakonore në forcimin e marrëdhënieve diplomatike dhe diplomacisë së butë mes dy vendeve. Studimi tregon se normat zakonore mbeten thelbësore në ndërtimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe forcimin e lidhjeve juridike dhe kulturore.

Fjalë kyçe: E drejta zakonore, ndërkombëtarizimi, tradita juridike, Shqipëri, Itali, diplomacia e butë, e drejta romake

Abstract

This paper explores the role of customary norms in the internationalization process, focusing on Albania and Italy. It highlights how customary law, derived from historical legal traditions, continues to shape international legal frameworks and diplomatic relations. The study examines the influence of Roman legal heritage on Albanian customary law, emphasizing key similarities in legal principles, family structures, and dispute resolution. Additionally, it discusses the role of shared legal traditions in fostering diplomatic cooperation and soft diplomacy between the two nations. The findings suggest that customary norms remain crucial in shaping international interactions and strengthening legal and cultural ties.

Keywords: Customary law, internationalization, legal traditions, Albania, Italy, soft diplomacy, Roman law

Kryefjala sot, thuhet në mënyrë të paevitueshme dhe në çdo aspekt të jetës, duket se është ndërkombëtarizimi, bashkëpunimi në çdo sektor, politik, ekonomik, financiar, shoqëror, teknologjik, por edhe në fusha të tjera

delikate si drejtësia dhe arsimi. Globalizimi duket se ka përqaftuar shoqërinë në pothuajse të gjithë elemente e saj, duke u bërë pjesë e përditshmërisë sonë në çdo aspekt jetësor. Sot, jeta jonë është e lidhur pazgjidhshmërisht me fenomenet e ndërkombëtarizimit: ne blejmë online në çdo kohë dhe në çdo vend të botës, ne kemi mundësi të studiojmë apo të shkëmbejmë eksperiencën akademike me kolegë në çdo vend të botës falë programeve të posaçme, ne mund të punojmë kudo nëpër botë, qoftë edhe pa nevojën për tu ndodhur fizikisht aty, qeveritë e shteteve kanë plane të posaçme bashkëpunimi në rrafshin evropian dhe ndërkombëtar dhe të gjithë këto mundësi shkëmbimesh bëjnë që, në mënyrë të paevitueshme të vihen përballë njëra-tjetrës dhe të shkëmbehen kultura, zakone, tradita të ndryshme. Ato, gradualisht, hynë dhe bëjnë pjesë në jetët tona nëpërmjet politikave, kulturës, artit, ushqimit, veshjeve etj.

Siç thoshtë Donna në 1624 dhe më vonë Merton në 1955 “*asnjë njeri nuk është një ishull*”. Sot, ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi në rrafshin ndërkombëtar nuk është zgjedhje por një domosdoshmëri për mbijetesë dhe në këtë aspekt, analiza e diferencave kulturore merr përmasa të rëndësishme në studimin e fenomenit të ndërkombëtarizimit, si për ndikimin që ato mund të kenë në përcaktimin e politikave globale, ashtu edhe në ndihmesën e madhe që ato mund të japin në të ashtuquajturën “*soft diplomacy*”.

Marrëdhëniet midis shteteve dhe organizmave të tjera ndërkombëtar janë të rregulluara përveç se nga traktatet, edhe nga normat juridike jo të shkruara që kanë natyrë zakonore: nga ajo që gjerësisht quhet “*e drejtë zakonore*”. Për të patur një normë zakonore, normalisht duhet të bashkëekzistojnë dy elementë kryesor: a) *elementi objektiv apo material*, që ka të bëjë pikërisht me përsëritjen, vazhdueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në kohë të një veprimi apo sjellje të caktuar nga pjesa më e madhe e subjekteve; dhe b) *elementi subjektiv apo psikologjik*, që ka të bëjë me bindjen e brendshme se ky veprim apo kjo sjellje e caktuar është në përputhje të plotë me normat e së drejtës dhe ndjehet si i nevojshëm.

Në nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, nen i cili përcakton mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis shteteve, e drejta zakonore zë një vend të rëndësishëm pasi konsiderohet si një provë për një praktikë të përgjithshme, të aplikuar në kohë dhe hapsirë si dhe të pranuar si e drejtë për pjesën më të madhe të subjekteve.

Ndryshe nga traktatet që janë të vlefshëm vetëm në raport midis palëve (*e drejtë ndërkombëtare e posaçme*) normat zakonore janë detyruese për të gjithë subjektet ndërkombëtare (*e drejtë ndërkombëtare e përgjithshme*), pavarësisht pjesëmarrjes në procesin e formimit të kësaj norme. Një pjesë e doktrinës, normat zakonore ndërkombëtare i percepton si marrëveshje të heshtura

por, mendimi që prevalon është ai se në të vërtetë, normat zakonore janë një burim autonom i së drejtës dhe traktatet janë ata që duhet të konsiderohen si burim që e përfton ligjshmërinë pikërisht nga e drejta zakonore (*pacta sunt servanda*). Normat zakonore kryesisht kanë funksionin e përcaktimit të disa parimeve juridike të përgjithshme, të domosdoshme për bashkëjetesën midis kombeve. Rëndësia e tyre fillestare ka qënë shumë e madhe por, pas luftës së dytë botërore, me rritjen e numrit të subjekteve ndërkombëtare, diferencave politike, sociale dhe ekonomike midis shteteve, ato e humbën ndikimin fillestar. Pavarësisht kësaj, ato vazhdojnë të ruajnë një pozitë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme në rrafshin juridik ndërkombëtar pasi, duke qënë të detyrueshme për të gjithë, sigurojnë unitetin e sistemit juridik përkundrejt fragmentarizimit të këtij sistemi që mund të vij si pasojë e traktateve.

Ndikimi i normave zakonore ka një rëndësi të veçantë edhe në rastin e raporteve që krijohen midis dy apo më shumë subjekteve ndërkombëtar. Ngjashmëria e normave juridike dhe zakoneve, traditave, kulturës, kodeve morale, mënyrës së jetesës etj., sigurisht që ka një ndikim të madh në afërsinë e shteteve dhe gjetjen më shpejtë dhe më lehtë të rrugëve të dialogut dhe bashkëpunimit. Përgjithësisht, kjo vjen nga një bazë dhe traditë juridike e përbashkët apo ndikimit të njërës tek tjetra.

Një rast interesant dhe i vlefshëm në këtë aspekt është ai i Shqipërisë dhe Italisë. Nëse studiojmë me kujdes normat zakonore juridike të të dy vendeve gjejmë ngjashmëri të rëndësishme pasi, në të vërtetë, të dyja i gjejnë bazat tek ato që quhen "*mores maiorum*" të të drejtës romake, pikërisht normat zakonore që i dhanë jetë sistemit juridik më të hershëm dhe njëkohësisht më të përpunuar në botë, atij romak. Krahu i Ilirikut ishte pjesë e rëndësishme e perandorisë romake dhe qeverisej nga pretorët romakë, së bashku me administratën e tyre. Shqipëria e sotme bën pjesë pikërisht në territoret e kësaj krahu dhe rrjedhimisht, me qindar shekuj u qeveris dhe administrua nga pretorët romakë, të cilët, në fillim të cdo viti të detyrës së tyre shpallnin dhe bënin publik trupin e normave ligjore mbi bazë të të cilave do të qeverisnin territorin ku ata do të ushtronin detyrën. Në këto kushte, duke qënë se me qindra shekuj krahu i Ilirikut u qeveris dhe administrua nga pretoret romake, normat ligjore por edhe zakonore të tyre u nguliten fort në vend. Ndaj, ndikimi dhe influenca e normave juridike romake në të drejtën zakonore shqiptare është shumë e madhe dhe sot edhe kësaj dite, kryesisht të ruajtura në kanunet tona.

Ngjashmëritë e shumta i ka analizuar në mënyrë të veçantë një ndër figurat më të shqura shqiptare, Prof. Ernest Koliqi, duke i bërë publikë në një leksion të mbajtur në Univiersitetin e Romës "La Sapienza" në vitin 1942.

Analiza e ngjashmërive të normave juridike zakonore fillon që nga parimet

bazë të këtyre sistemeve juridike siç janë institutet e besës dhe nderit, me detyrimin për të mos kryer veprime që bien ndesh me moralin dhe ç'nderojë individin. Të dy këto institute i gjejmë si në “mores maiorum” të të drejtës zakonore romake, ashtu edhe të ngulitura fort edhe sot e kësaj dite në sistemet si shqiptare, kryesisht në kanune, ashtu edhe në ato italiane, kryesisht në kodet zakonore të disa krahinave të caktuara sic është Barbagia në zemër të ishullit të Sardenjës.

Ngjashmeri të mëdha gjenden edhe brenda organizimit familjar ku në të drejtën romake gjejmë në krye të familjes atë që quhej “*paterfamilias*”, ose babai i shtëpisë, figurë të cilën, në të drejtën zakonore apo kanunore shqiptare e gjejmë nën petkun e “Zotit të Shtëpisë”. Në të dy rastet, ai ishte kryetari i famijes, ai që kishte pushtet të plotë mbi të gjithë anëtarët e tjerë të familjes të cilët gjendeshin nën pushtetin e plotë të tij, aq sa ai kishte dhe të drejtën e jetës dhe vdekjes mbi ta “*ius vita ac necis*”. Ai drejtonte familjen në çdo aspekt, social, ekonomik dhe shoqëror. Në të dy rastet, përvec të drejtave, edhe detyrimet binin po mbi “*paterfamilias*” apo “*zoti i shtëpisë*” pasi ishte ai që përgjigjej për të gjithë detyrime familjare apo ato të kontraktuara nga personat e tjerë të familjes. Si Paterfamilias si Zoti i Shpisë kishin detyrimin në përfaqësonin famijet e tyre si në marrëdhënie me familjet e tjera, ashtu edhe në mbledhjet e ndryshme popullore apo organe vendimmarrëse lokale. Të dy këto figura kanë luajtur në kohë rolin e ndërmjetësve në konflikte të ndryshme brenda komuniteteve, duke përfaqësuar ndoshta fillesat e artit të diplomacisë. Ngjashmëri të rëndësishme gjejmë edhe në lidhje me të drejtat pronësore, që kryesisht i referohen faktit të pushtetit të plotë pronësor dhe vendimmarrës të “*paterfamilias*” dhe “Zot i Shtëpisë”, si përsa i përket përcaktimit të kufijve, të drejtave të tjetërsimit të pronës ashtu edhe administrimit të saj. Elementë të rëndësishëm të bashkimit të kulturave dhe traditave lidhen edhe me aspektet trashëgimore, kryesisht trashëgimia në linja mashkullore apo institutet e “*dos*” apo “*pajës*” të cilat përfaqësojnë në të dy kulturat e lashta, të mbetura edhe sot, kuotën trashëgimore të vajzës, e cila në të vërtetë bëhej pjesë e pasurisë së burrit apo vjehrrit të saj me qëllim përballimin e jetës së përbashkëti familjare, përsa kohë, në të dy këto sisteme normash zakonore, gruaja nuk ka të drejtë pasurore. Elementë të tjerë të përbashkët gjejmë edhe në modalitetet e organizimit të proceseve gjyqësore të kryera përmes betimeve dhe formulave solemne, në prani të dëshmitarëve dhe mbështetje të fortë në parimin e mirëbesimit në të dy rastet.

Të gjithë këto ngjashmëri në aspektin zakonor juridic, që gjenë rrënjë të thella dhe të forta në sistemin juridic romak, sot të trashëguara dhe që përbëjnë thelbin e ngjashmërive të sistemeve juridiko – zakonore të shqipërisë dhe italisë, mendojme se kanë ndikuar në mënyrë pozitive në krijimin e

marrëdhënieve shumë të mira dhe të afërta midis këtyre dy shteteve dhe kombeve, dhe kjo që prej lashtësisë. Traditat dhe normat morale të përafërta janë një element themelor për krijimin e rrugëve të bashkëpunimit pasi aspekti social dhe shoqërore është element fundamental në gjetjen e një rruge të përbashkëtu ku palët e këtij procesi të mund të ecin në harmoni me njëra-tjetrën. Identifikimi dhe evidentimi i këtyre elementëve bashkues mendojmë se ka vlerë të madhe në aspektin e ndërveprimit ndërkombëtar dhe ecurisë positive në zhvillimin e bashkëpunimeve në rrafshin ndërkombëtar.

Kjo bashkësi vlerash ka ndikuar gjithashtu në mënyrën se si Shqipëria dhe Italia kanë ndërvepruar me shtete të tjera, duke përdorur normat e zakonshme si një urë lidhëse për diplomacinë e butë. Diplomacia e butë është një formë e diplomacisë që përqendrohet më shumë në ndikimin kulturor, edukativ dhe social sesa në përdorimin e forcës ose mjeteve të tjera të ashpra. Në këtë kontekst, Shqipëria dhe Italia kanë përdorur ndihmën e normave zakonore për të krijuar një imazh të përbashkët dhe për të promovuar vlera të ngjashme përmes marrëdhënieve të tyre bilaterale dhe angazhimeve ndërkombëtare. Një shembull i këtij ndikimi mund të shihet në marrëveshjet e shumta që këto dy shtete kanë nënshkruar gjatë dekadave të fundit, duke përfshirë ato në fushën e arsimit, kulturës dhe ekonomisë, ku ndihma e normave të përbashkëta ka mundësuar një bashkëpunim të frytshëm dhe të qëndrueshëm.

Në aspektin diplomatik, normat zakonore që lidhin Shqipërinë dhe Italinë kanë ndihmuar gjithashtu në zhvillimin e një komunikimi të hapur dhe të lehtë në çështje të ndjeshme. Kjo ka kontribuar në zbutjen e tensioneve dhe ka mundësuar një qasje më të mirë për të zgjidhur mosmarrëveshjet pa pasur nevojë për përdorimin e forcës apo sanksioneve të tjera. Për shembull, marrëveshjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe bashkëpunimi në fushën e turizmit, janë disa prej fushave ku normat e zakonshme kanë mundësuar që këto dy shtete të krijojnë një partneritet të qëndrueshëm dhe me interes të përbashkët. Në këtë mënyrë, normat juridike dhe zakonet e përbashkëta janë shndërruar në një mjet të fuqishëm për promovimin e marrëdhënieve paqësore dhe të dobishme për të dyja palët.

Kjo marrëdhënie e ngushtë mes Shqipërisë dhe Italisë, e bazuar në vlera të përbashkëta, ka krijuar mundësi të shumta për zhvillimin e diplomacisë së butë në nivel ndërkombëtar. Pjesëmarrja e këtyre dy shteteve në organizata ndërkombëtare, si Kombe të Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Europian, ka mundësuar përdorimin e këtyre normave zakonore për të promovuar paqen dhe stabilitetin në rajon, duke përfshirë integrimin e shteteve të tjera të Ballkanit në strukturat ndërkombëtare. Edhe sot, në përpjekjet e saj për aderim me të drejte të plota në Bashkimin Evropian, Shqipëria gjen në krah si partneren e saj më të fortë e më besnike pikëshit Italinë. Shqipëria dhe

Italia kanë mundur të përdorin lidhjet e tyre të ngushta, të bazuara në norma të përbashkëta, për të mbështetur reforma të rëndësishme në rajon, si dhe për të promovuar një rend të bazuar në ligj dhe respekt për të drejtat e njeriut.

Përveç kësaj, ndikimi i normave zakonore ka qenë thelbësor edhe në forcimin e marrëdhënieve kulturore dhe edukative mes dy shteteve. Në fushën e arsimit, shkëmbimi i studentëve dhe profesorëve, si dhe organizimi i aktiviteteve kulturore, kanë krijuar mundësi për të thelluar njohuritë dhe për të forcuar lidhjet ndërmjet shoqërive të dy shteteve. Normat e përbashkëta kanë ndihmuar gjithashtu në krijimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunimin në fushën e biznesit, ku sipërmarrësit dhe investitorët italianë dhe shqiptarë kanë mundur të punojnë së bashku në një atmosferë të besimit të ndërsjellë dhe respekti për rregullat dhe normat e përbashkëta.

Në përfundim, mund të theksojmë se normat zakonore të përbashkëta midis Shqipërisë dhe Italisë janë një burim i rëndësishëm i bashkëpunimit dhe ndikimit në diplomacinë e butë, si dhe një faktor kyç për forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky bashkëpunim, i bazuar në trashëgiminë juridike dhe kulturore të përbashkët, ka mundësuar krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale dhe për promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në botë. Si rezultat, Shqipëria dhe Italia janë shembuj të mirë të mënyrës se si normat zakonore mund të shërbejnë si një mjet i fuqishëm për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të kontribuar në zhvillimin e një rendi ndërkombëtar të qëndrueshëm dhe të paqes.

Bibliografia:

AT GJECOVI, SHTJEFEN, *“Kanuni i Lek Dukagjinit, Shtypshkronja Françeskane, Shkoder, 1933.*

AT VALENTINI, GIUSEPPE (ZEF), *Studime dhe tekste juridike, Plejad, Tirane, 2009.*

LUARASI, ALEKS; OMARI, LUAN, *Historia e shtetit dhe se drejtes ne shqiperi, Luarasi University Press, Tirane, 2007.*

PIGLIARU, ANTONIO, *Il Banditismo in Sardegna. La vendetta barbaricina come ordinamento giuridico, Giuffrè Editore, Varese, 1975.*

DURHAIM, EDITH, *Albania and the Albanians, 1903-1944, Tauris, Tirana, 2001.*

KOLIQUI, ERNEST, *Il diritto Albanese del Kanun e il Diritto Romano,*

Lezione tenuta presso il Reale Istituto di Studi Romani, Roma, il 27 Marzo 1942, Instituti i Studimeve Shqiptare; Studime e Tekste, Dega I, Juridike, No.1, pp. 1-27, 1943.

ÇABEJ, EQEREM, *Zakone dhe doke te shqiptareve*, Vol. V, Prishtine, 1975.

LILLIU, GIOVANNI, *La costante resistenziale Sarda (a cura di Antonello Mattone)*, Ilisso Edizioni, Nuoro, 2002.

CASTELLETTI, GIUSEPPE, *Normat zakonore dhe jeta shoqerore ne malesite shqiptare, sipas Kanunit te Leke Dukagjinit (Consuetudini e vita sociale nelle montagne albanesi secondo il Kanun i Lek Dukagjinit, Studi Albanesi 3-4, Roma 1933)*, OMBRA BVG, Tirane 2012.

